

Kosova dhe Armët:
Vlerësim Bazë i Armëve të Vogla
dhe të Lehta në Kosovë

Anna Khakee
Nicolas Florquin

Qershor, 2003



Studim i autorizuar nga
Programi për Zhvillim i
Kombeve të Bashkuara (UNDP)

Publikimi i përbashket i
Programit për Zhvillim i
Kombeve të Bashkuara (UNDP)
dhe Small Arms Survey

Kosova dhe Armët: Vlerësim Bazë i Armëve të Vogla dhe të Lehta në Kosovë

Anna Khakee
Nicolas Florquin

Qershor 2003

Pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk shprehin domosdoshmërisht pikëpamjet e UN apo të UNDP-së

Studim i autorizuar nga
Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
©UNDP

Materialet e këtij publikimi nuk mund të shfrytëzohen, të riprodhohen apo transmetohen, në tërësi apo pjesërisht, në asnjë formë apo qëllim, pa referimin e Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) si burim. Ky publikim nuk mund të shfrytëzohet për qëllime komerciale.

Publikimi i përbashkët i Programit për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
dhe Small Arms Survey

UNDP/ISAC

UNDP është një rrjet global zhvillimor i OKB-së që avokon për ndryshime dhe i lidh njerëzit me njohuri, përvoja dhe burime në mënyrë që t'u ndihmojë të ndërtojnë jetë më të mirë. Në Kosovë, energjitë e UNDP-së janë drejtuar drejt kthimit të besimit ndër historitë dhe bashkësitë kryesore të Kosovës. Projektet e UNDP-së në fushën e sigurisë janë të bazuara në premisat se stabiliteti dhe rendi e ligji janë të pandashme me zhvillimin.

Projekti për Kontrollin e Armëve të Vogla të Paligjshme i UNDP-së ISAC kërkon t'i adresojë çështjet e posedimit të armëve të vogla dhe përdorimin në shoqëri postkonfliktuale. Duke punuar ngusht me Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ISAC ndihmon zhvillimin e një kornize rregullative të gjerë mbi armët e lehta dhe të vogla. ISAC promovon Armët në Këmbim të Zhvillimit (AKZh) përmes një vetëdijesimi publik si dhe Përfshirjen e Shoqërisë Civile, dhe fondeve për shkatërrimin e armëve.

Small Arms Survey

Small Arms Survey është një projekt i pavarur hulumtimi i lokalizuar në Institutin Studimor të Studimeve Ndërkombëtare në Gjenevë, Zvicër. Po ashtu është i lidhur me Programin e Institutit Studimor për Studime Strategjike Ndërkombëtare të Sigurisë.

I themeluar në vitin 1999, projekti është i përkrahur nga Departamenti Shtetëror Zviceran i Punëve të Jashtme, dhe kontributi nga qeveritë e Australisë, Belgjikës, Kanadasë, Danimarkës, Finlandës, Francës, Holandës, Zelandës së Re, Norvegjisë, Suedisë dhe të Britanisë. Bashkëpunon me institutet kërkimore dhe organizatat joqeveritare në shumë vende duke përfshirë Brazilin, Kanadanë, Gjeorgjinë, Gjermaninë, Indinë, Izraelin, Norvegjinë, Federatën Ruse, Afrikën e Jugut, Shri Lankën, Suedinë, Tajlandën, Britaninë e Madhe si dhe ShBA-në.

Seritë e prezentimeve të herëpashershme të Small Arms Survey paraqesin kerkime të reja dhe substanciale hulumtuese me stafin e projektit dhe hulumtuesit të përqendruar mbi të dhënat, dhe çështjet metodologjike dhe konceptuale të lidhura me armë të vogla ose me studime të detajuara për shtete dhe rajone. Seritë botohen në periodikisht dhe gjenden në edhe kopje edhe në faqen e projektit në internet.

Small Arms Survey

Graduate Institute of International Studies

47 Avenue Blanc

1202 Gêneve

Zvicër

tel: + 41 22 908 5777

Fax: + 41 22 732 2738

email: smallarm@hei.unige.ch

Web site: <http://www.smallarmssurvey.org>

SAS Punime rasti

- Nr. 1 *Re-Armament in Sierra Leone: One Year After the Lomé Peace Agreement*, nga Eric Berman, Dhjetor 2000
- Nr. 2 *Removing Small Arms from Society: A Review of Weapons Collection and Destruction Programmes*, nga Sami Faltas, Glenn McDonald, dhe Camilla Waszink, Korrik 2001
- Nr. 3 *Legal Controls on Small Arms and Light Weapons in Southeast Asia*, by Katherine Kramer (with Nonviolence International Southeast Asia), Korrik 2001
- Nr. 4 *Shining a Light on Small Arms Exports: The Record of State Transparency*, nga Maria Haug, Martin Langvandslien, Lora Lumpe, dhe Nic Marsh (me NISAT), Janar 2002
- Nr. 5 *Stray Bullets: The Impact of Small Arms Misuse in Central America*, nga William Godnick, me Robert Muggah dhe Camilla Waszink, Nëntor 2002
- Nr. 6 *Politics from the Barrel of a Gun: Small Arms Proliferation and Conflict in the Republic of Georgia*, nga Spyros Demetriou, Nëntor 2002
- Nr. 7 *Making Global Public Policy: The Case of Small Arms and Light Weapons*, nga Edward Laurance dhe Rachel Stohl, Dhjetor 2002
- Nr. 8 *Small Arms in the Pacific*, nga Philip Alpers dhe Conor Twyford, Mars 2003
- Nr. 9 *Demand, Stockpiles, and Social Controls: Small Arms in Yemen*, nga Derek Miller, May 2003

Përmbajtja

Mirënjohjet	v
Akronimet dhe shkurtesat	vi
Fjalorth termash	vii
Lista e tabelave, figurave dhe kutive	vii
Përmbledhje e përgjithshme	viii
I. Hyrje	1
II. Kosova: E kaluar e vështirë, e ardhme e paqartë	4
III. Perceptimet e sigurisë dhe ofruesit e sigurisë	7
Llojet dhe shkalla e dhunës si dhe pasiguria në Kosovë	7
Perceptimet e ofruesve të sigurisë	9
IV. Sa armë ka në Kosovë?	11
Mbajtësit e ndryshëm të armëve në Kosovë	11
Vendosja e ligjit dhe Armët e TMK-së	11
Armatimet e formacioneve	12
Armatimet e civilëve	16
Përpjekjet për grumbullimin e armëve pas çmobilizimit zyrtar	21
Çmimet e armëve në tregun e zi	26
V. Trafikimi i armëve nëpërmjet kufijve të Kosovës	27
Hyrje	27
Marrëveshjet për kontrollin e kufijve	27
Trafikimi nëpër pika kufitare kontrolli	28
Rrugët e trafikimit, kufiri i gjelbër, dhe tregtimi i brendshëm	29

VI. Kultura e armëve dhe rregulloret e armëve, dikur dhe sot	31
Kultura e armëve ndër shqiptarët e Kosovës: 'Votra pa armë nuk është shtëpi'	31
Qëndrimet ndaj armëve në Kosovën e sotme	32
Ligjet mbi armët në Kosovë	34
VII. Efektet e drejtpëdrejta dhe të tërthorta të armëve në Kosovë	35
Hyrje	35
Lëndimet fatale dhe jofatale	35
Armët në krim	36
Mjedise pa armë? Armët dhe shkollat	39
VIII. Përfundimet	41
Fundnotat	42
Shtojca 1: Përgjegje në pyetje të përzgjedhura të anketës së SABA-se	46
Shtojca 2: Pyetësi i SABA-se për anketën nëpër familje	53
Shtojca 3: Ndryshoret në indeksin e zbatueshmërisë dhe rrezikshmërisë	62
Shtojca 4: Komunitatet e Kosovës të rankuara sipas indeksit të zbatueshmërisë dhe të rrezikshmërisë	63
Shtojca 5: Të dhënat e përdorura në figura	64
Burimet	69
Bibliografia	69
Intervistat	71

Mirënjohjet

Ky raport bazohet në kërkimet në zyrë dhe në terren të kryera nga një ekip katëranëtarësh i Small Arms Survey nga Janari deri në Mars të vitit 2003. Raporti është hartuar nga Anna Khakee, me përkrahje për hulumtim dhe përpilim të tekstit nga Nicolas Florquin. Editoriali dhe të hyrat e hulumtimeve po ashtu janë mundësuar nga Keith Krause dhe Robert Muggah, dhe ndihmesa për hulumtime nga James Bevan, Aaron Karp, dhe Elli Kytömäki.

Nuk do të mund ta mblidhnim infomacionin për këtë raport pa bashkëpunimin e shumë njerëzve në Kosovë, të cilëve u shprehim falënderimet më të sinqerta. Falënderime të veçanta i detyrojmë znj. Marie-France Desjardins, dhe personelit të Projektit të UNDP-së për Kontrollin e Armëve të Vogla të Paligjshme (Illicit Small Arms Control-ISAC): Andrew House, Fadil Jakupi, Branko Jurisic, Yukari Ota, Xheraldina Pufja, dhe Lendita Polloshka. Po ashtu, i detyrohem edhe personelit të Index Kosovës (në një bashkëpunim me Gallup International), dhe sidomos Visar Berishës, Vlora Bashës, Genc Krasniqit, Shemsi Krasniqit dhe Imer Muzhakut, personelit të Gallup International (Assen Blagoev, Sladjana Djuric, Gordana Cuk dhe Nikola Cuk) dhe atij të Nismës Kosovare për Shoqëri Demokratike (Xheraldina Cërnobregu dhe Valon Murati), Ismail Hasanit nga Universiteti i Prishtinës, Afrim Lokut nga Spitali Universitar i Prishtinës, dhe John Avery nga Policia e UNMIK-ut. Po ashtu i falënderohemi Nick Booth, Isabelle Congras, Spyros Demetriou, Ismail Dërguti, Aude Fieschi, Wolf Christian Paes, Olivier Pascau, personelit të KFOR-it, Ministrise se Edukimit Shkences dhe Teknologjise (MESHT) te Kosovës dhe Derek Lutterbeck.

Shumë njerëz që ofruan informata ose u pajtuan të intervistoheshin kërkuan të mbeten anonimë, dhe u jemi mirënjohës për gatishmërinë që ta ndajnë kohën dhe të japin njohuritë e tyre për ekipin tonë kërkimor. Lista e intervistave kryesore është e dhënë me burimet e këtij raporti. Të gjitha gabimet në interpretim ose fakte janë përgjegjësi e ekipit hulumtues Small Arms Survey.

Akronimet dhe shkurtesat

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AJ	Armata Jugosllave
AKZh	Armët në Këmbim të Zhvillimit
AVL	Armët e Vogla dhe të Lehta
BE	Bashkimi Europian
BShK	Brigada Shumëkombëshe
CIVPOL	Civilian police (International Civilian police Force) Policia civile (forca policore civile ndërkombëtare)
IOM	(International Organisation for Migration) Organizata Ndërkombëtare për Migrim
IPV	Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes
IRJM	Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë
ISAC	Illicit Small Arms Control Project (Projekti: Kontrolli i Armëve të Vogla të Paligjshme UNDP-së)
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
KAA	Karta për Autorizimin e Armëve
KIDS	Kosovo Initiative for a Democratic Society (Iniciative Kosovare për Shoqëri Demokratike)
KFOR	Kosovo Force (Forcat për Kosovën)
NJSU	Njësi e Specializuar Ushtarake
MD	Mortaja e Dores
MUP	Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë
NATO	North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
OSA	Armata Çlirimtare Serbe
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSCE- Organization for Security and Cooperation in Europe)
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm [i Kombeve të Bashkuara]
SABA	Small Arms Baseline Assessment (Vlerësimi Bazë për Armët e+ Vogla ndërmarrë nga SAS për ISAC e UNDP-së në Kosovë)
SAS	Small Arms Survey
SEESAC	South Eastern Europe Clearinghouse for Control of Small Arms and Light Weapons (Spastrimorja e Europës Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta)
SIPK	Sistemi Informativ i Policisë Kosovare
ShPK	Shërbimi Policor i Kosovës
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
UÇKomb.	Ushtria Çlirimtare Kombëtare (IRJM)
UÇPMB	Ushtria Çlirimtare e Preshevës, Medvegjës e Bujanovcit
UNDP	United Nations Development Programme (Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara)
UNMIK	United Nations Interim Mission in Kosovo (Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)
VKA	Vijë Kufitare Administrative (që ndan Kosovën nga Serbia dhe Mali i

Fjalorth termash

Vijë kufitare administrative	Kufiri mes Kosovës në një rën anë dhe Serbisë e Malit të Zi në tjetrën
Kufiri i gjelbër	Kufiri ndërmjet pikave kufitare të kalimit /pikave ndërkombëtare të kalimit të kufirit
Armët e lehta	Pushkë të rënda automatike, granatahedhësit cilindrikë të dorës dhe të montueshëm, automatikë të lëvizshëm anti-tank dhe antiaviacion, pushkë joautomatike, lançues të lëvizshëm të sistemeve raketore antitank dhe antiaviacion, dhe granata të kalibrit prej më pak se 100mm.
Armë të vogla	Revolverë dhe pistoleta automatike, pushkë dhe karabina, pushkë sulmi, pushkë gjysmëmitraloz, dhe mitraloz i vogël
Policia e UNMIK-ut	Përbëhet nga CIVPOL-i ndërkomb. dhe ShPK-ja

Lista e tabelave, figurave dhe kutive

Tabelat

- Tabela 4.1 Totali i pandehur i armëmbajtjes nga kosovarët (të ligjshme dhe të paligjshme), 2003
- Tabela 4.2 UÇK dhe Armatimet paramilitare të serbëve të Kosovës më 1999
- Tabela 4.3 Rezultatet e amnestisë për armë më 2001 dhe 2002
- Tabela 4.4 Armët e kapura nga KFOR-i, 1 Janar-12 Mars 2003
- Tabela 4.5 E humbur-e gjetur: Armët e rrëmbyera dhe të kthyera në Shqipëri, Mars 1997-Shtator 2001

Figurat

- Figura 3.1 Nivelet e krimit në Kosovë në pikëvështrim krahasues
- Figura 4.1 Tipet e AVL-ve të kapura nga policia, 2000-2002
- Figura 4.2 Prodhuesit e pushkëve sulmuese
- Figura 4.3 Prodhuesit e pistoletave
- Figura 4.4 Shpërndarja gjeografike e kapjeve të policisë, mesi i vitit 2000 deri në fund të 2002
- Figura 4.5 Krahasimi i rezultateve të operacioneve të kapjes nga KFOR-i dhe amnestisë së armëve, 15 Mars-15 Prill 2002
- Figure 4.6 Armët e kapura nga trupat e KFOR-it më 2001 dhe 2002
- Figure 7.1 Raporti spitalor mbi arsyet e vizitave/lëndimeve
- Figure 7.2 Përqindjet e krimeve të raportuara të kryera me AVL, kategori të përzgjedhura
- Figure 7.3 Tipet e AVL-ve të përdorura në vrasje, 2002
- Figure 7.4 Tipet e AVL-ve të përdorura në rrëmbime, 2002
- Figure 7.5 Tipet e AVL-ve të përdorura në plaçkitje, 2002
- Figure 7.6 Tipet e AVL-ve të përdorura në sulmet e provokuara, 2002

Kutitë

- Kutia 1.1 Gjenerimi i informatave të reja: Të dhënat dhe burimet e studimeve
- Kutia 1.2 Grumbullimi i armëve nga UNDP në Kosovë
- Kutia 3.1 Anketa në Amvisëri e SABA-së
- Kutia 3.2 Kërkimi në grupe të synuara në Kosovë
- Kutia 4.1 Posedimet e pandehura të armëve
- Kutia 4.2 Armet ne jeten politike te Kosoves
- Kutia 4.3 Trashëgimia nga Marsi 1997
- Kutia 6.1 Historia e grumbullimit të armëve në Kosovë
- Kutia 6.2 Zjarri festiv

Përmbledhje e përgjithshme

Kosova shënon shumë dekada të trazirave dhe të persekutimeve, dhe siguria e qytetarëve mbetet një shqetësim serioz në Kosovën e pasluftës. Ndonëse prania e dhunës së armatosur është ulur që nga fushata e NATO-s më 1999, civilët që jetojnë në këtë terror (dhe agjencitë ndërkombëtare që punojnë këtu) janë megjithatë të cenueshem. Gjendshmëria e përhapur dhe shpërdorimi i armëve të vogla, posaqerisht i pistoletave dhe pushkëve automatike, përbëjnë një sfidë qendrore për uljen e pasigurisë dhe nxitjen e zhvillimit në gjithë Kosovën.

Përkundër faktit se gjendshmëria e armëve të vogla daton që para pranisë Osmane në rajon -- dhe përkundër rolit kyç që armët kishin për nxitjen e pasigurisë në vitet 1990 dhe në fillim të shek. XXI - shumë pak dihet për atë se sa armë qarkullojnë, si dhe nga kush mbahen, si perceptohen armët, dhe cilat janë ndikimet a armëve ndaj individëve dhe shoqërisë.

Projekti "Kontrolli i Armëve të Vogla të Paligjshme" ISAC i UNDP-së në Kosovë e ka kuptuar këtë mangësi të madhe në njohurinë që kemi për armët. Duke kuptuar se gjendshmëria e armëve të vogla dhe shpërdorimi i tyre paraqesin një pengesë për përmbushjen e mandatit themelor, UNDP-ja rishtas ka lansuar Projektin për Kontrollin e Armëve të Vogla të Paligjshme ISAC. ISAC ka katër nënpër-bërës, një nga të cilët është "Armët në Këmbim të Zhvillimit" (AKZh). Në mënyrë që të kuptohet më mirë roli i armëve të vogla në Kosovë dhe të vendosen nivele dhe standarde të matshme për AKZh-në, UNDP/ ISAC ka komisionuar Small Arms Survey që të kryejë një Vlerësim Bazë për Armët e Vogla - SABA

viii

Përmes një kombinimi të kërkimeve të ndryshme dhe instrumenteve të anketimit,¹ SABA mëton t'u përgjegjet 5 pyetjeve kyçe: (1) sa armë të vogla ka në Kosovë dhe si shpërndahen ato; (2) çfarë lloje të armëve raportohen më së shpeshti dhe shpërdoren; (3) cilët janë pronarët fillestarë dhe përdoruesit të armëve të vogla dhe cilat janë qëndrimet e tyre ndaj armëve; (4) si transferohen armët e vogla dhe cila është shkalla dhe dinamika e tregtimit me armë të vogla; dhe (5) cilat janë efektet e drejta dhe të zhdrejta të shpërdorimit të armëve të vogla në civilët dhe personelin ndërkombëtar? Gjetjet e përgjithshme janë pasqyruar më poshtë.

Ka afro 330.000-460.000 armë të vogla në duar të civilëve në Kosovë sot. Ndonëse ShPK-ja, TMK-ja, ofruesit ndërkombëtarë të sigurisë si dhe shumë kompani private të sigurimit si dhe një grup i përzgjedhur i veprimtarëve politikë kanë qasje ndaj përdorimit të armëve vetjake, shumica dërmuese- ndër-mjet 330.000 dhe 460.000-mbahen nga civilët.² Armë e vogla shpërndahen në mënyra të ndryshme brenda popullatës civile - edhe gjeografikisht edhe demografikisht. Gjeografikisht, armët e vogla mbi-zotërojnë në zonat rurale dhe gjysmë rurale më shumë sesa në qendrat urbane. Ndonëse armët e vogla janë nga natyra të lëvizshme, duket se ato janë të përqendruara kryesisht në rajone si Mitrovica dhe Peja. Armët e vogla kryesisht mbahen brenda në shtëpi, në vende të fshehta, ose të janë të varrosura diku afër shtëpisë. Profili demografik i pronarëve të armëve të vogla duket se përkon me rajonet e tjera të Ballkanit: janë meshkujt mbi moshën 18 vjeçare.

Armët më të rëndomta në qarkullim janë pistoletat dhe pushkët e sulmit. Llojet e armëve që raportohen më së shpeshti nga Policia e UNMIK-ut si dhe nga grupet e synuara dhe anketat, përfshijnë pistoletat Zastava dhe Tokarev si dhe pushkët e sulmit Kalashnikov dhe Zastava. Ndonëse Zastava dhe Tokarev përbëjnë 53 për qind të gjithë pistoletave të raportuara, llojet e tjera si Berettat (7%) dhe

Ceska Zbrojovka (6%) janë raportuar po ashtu. Të paktën 85% të të gjitha pushkëve të sulmit të raportuara ishin Kalashnikovë dhe 14 për qind Zastava. Llojet e tjera të armëve të raportuara përfshijnë pushkët dhe pushkët e gjahut, e shumë më pak raketahedhësit, pushkët gjysmëmitraloz, snajperët dhe granatat.

Armët e vogla posedohen dhe përdoren nga një varg njerëzish. Përveç ofruesve kryesorë të sigurisë si KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut, armët e vogla posedohen dhe shpërdoren nga kriminelë të organizuar dhe të gjysmorganizuar, biznesmenë dhe ish-luftëtarë. Kompanitë private të sigurimeve dhe një numër politikanësh po ashtu kanë të drejtë të kenë "kartelat për autorizimin e armëve" (KAA) dhe të mbajnë numër të vogël armësh. Një tjetër kategori e pronarëve përfshin gjuetarët dhe qitësit rekreativë, të cilët kanë të drejtë të posedojnë armë gjuetie mbas marrjes së kartës së regjistrimit të armës.

Qëndrimet kundrejt ofruesve të sigurimit ndryshojnë ndërmjet kosovarëve. Anketat e SABA tregojnë se qëndrimet kundrejt ofruesve primarë të sigurisë (KFOR, ShPK, CIVPOL) ndryshojnë shumë ndërmjet shqiptarëve dhe pakicës serbe. Derisa të parët shfaqin besim ndaj ShPK-së dhe, më pak ndaj KFOR-it, serbët e Kosovës janë tejet skeptikë dhe madje armiqësor ndaj ShPK-së. Megjithatë, fëmijët dhe rinia shqiptare, si dhe ata të pakicës serbe të Kosovës, thonë se mbështeten kyesisht në vetveten dhe në armë për sigurinë e tyre vetjake.

Kosovarët nuk duket se janë aq të lidhur me armët sa besohet. Ndonëse qëndrimet kundrejt armëve të vogla ndër Shqiptarët e Kosovës dhe të pakicës serbe ndryshojnë jashtëzakonisht, SABA dëshmon se 47 për qind të kosovarëve besojnë se ka 'tepër shumë armë në shoqëri' dhe vetëm 21 për qind nuk pajtohen me këtë deklaratë. Kështu, mbi 50 për qind të respondentëve menduan se 'ka shumë gjasa' ose 'ka pak a shumë gjasë' që njerëzit e lagjes së tyre t'i dorëzojnë armët në këmbim të investimeve zhvillimore në bashkësinë e tyre. Së fundi, më se 50 për qind të respondentëve pohojnë se nuk do të zgjedhnin të posedonin armë edhe sikur ato të ishin të ligjshme.

Armët e vogla trafikohen kryesisht nga Serbia dhe Shqipëria dhe tregtia është relativisht e ulët krahasuar me shtetet e tjera të Ballkanit. Burimi primar i armëve për në Kosovë është Serbia (pistoletat e prodhimit Jugosllav dhe relativisht të shtrenjta) si dhe Shqipëria (pushkët e sulmit të prodhimit Kinez dhe relativisht të lira). Ka një numër arsyesh pse tregtimi dhe trafikimi i armëve të vogla është i kufizuar në Kosovë: mbi të gjitha, prania e madhe e forcave ndërkombëtare dhe vendase të sigurisë dhe profitet e ulëta krahasuar me trafikimin e femrave, të cigareve ose të karburantëve. Një shqetësim i shtuar, sidoqoftë, është dobësia e kontrollit të kufijve prandaj trafikimi i armëve të vogla mund të shtohet nëse kërkesa për armë të vogla shtohet coftë në Kosovë coftë në IRJM.

Lëndimet vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse me armë zjarri janë ulur që nga gjysma e dytë e vitit 1999. Bazuar në një studim epidemiologjik të komisionuar nga SAS, duket se numri i rasteve të raportuara është ulur më se 50 për qind ndërmjet mesit të vitit 1999 dhe vitit 2002. Ndonëse nivelet e raportimit janë padyshim të ulëta, dhe kapacitetet e shëndetit publik të kufizuara, duket se ky trend do të vazhdojë kështu gjatë vitit 2003.

Kriminaliteti, në veçanti krimi që përfshin armët e vogla, mbizotëron në Kosovë. Ndonëse nivelet e krimit (vrasja, plaçkitja dhe sulmi) në Kosovë janë analoge, ose edhe më të ulëta sesa ato të vendeve fqinje, rreth 72 për qind të të gjitha vrasjeve të raportuara më 2002 janë kryer me armë të vogla. Kjo është shifër e lartë kur të shikohet në kontekst: më se 13 për qind të të gjitha vrasjeve në Estoni, dhe 11 për qind në Hungari, janë kryer me armë të vogla, për shembull.

Për më shumë, armët e vogla kishin më se dy herë më shumë gjasë të përdoren në plaçkitje sesa në Estoni dhe katër herë më shumë sesa në Hungari. Po ashtu duket se, në Kosovë, pushkët janë vetë pjesë e problemit, meqë 'efekti i zëvendësimit' (kur të rrallohet njëri mjet, zëvendësohet me një tjetër për ta kryer krimin) nuk duket se është i fortë.

Incidentet që përfshijnë armë zjarri duken të rralla në shkolla dhe fakultete. Në një anketë të 15 shkollave në Kosovë, SABA dëshmon se armët si thikat dhe zinxhirët duken se janë mbizotëruese në dhunë kundrejt pistoletave ose pushkëve të sulmit. Armët e vogla vetëm ndonjëherë këmbehen për të tjera, ndonëse të ashtuquajturat 'armë të ftohta' janë shumë të përhapura dhe shpesh përdoren nëpër përleshje dhe për kërcënime. Respondentët tregojnë, sidoqoftë, për natyrën labile të sigurisë në shumë shkolla.

Kosova përballlet me një varg të gjerë sfidash strukturore, nga papunësia e përhapur deri te mangësitë substanciale në infrastrukturë dhe arsim. Ndonëse duhet t'i kushtohet vëmendje një numri të shqetësimeve zhvillimore legjitime, përpjekjet për ta përmirësuar situatën ekonomike nuk mund t'i anashkalojnë ndërhyrjet e shënuara të hartuara për ta ulur dhunën dhe pasigurinë, duke përfshirë pasigurinë dhe dhunën e lidhur me gjendshmërinë e armëve të vogla dhe shpërdorimin e tyre.

Pilotimi i programit "Armët në Këmbim të Zhvillimit" (AKZh) në verën e vitit 2003, nën shërbimin e Projektit UNDP/ISAC, do të jetë një tregues i rëndësishëm nëse një strategji gjithëkosovare e armëve për nisma zhvillimore është e dëshirueshme dhe e zbatueshme. Ndonëse planifikuesit dhe pjesëmarrësit e AKZh-së duhet t'i vënë vetes objektiva relativisht modeste - duke marrë parasysh përmasat e mëdha të detyrës dhe rrezikun e madh të përfshirë - përpjekjet e tyre duhet të përkrahen në nivelin më të lartë.

Gjetjet e SABA sugjerojnë se cilado AKZh e ardhshme duhet të përqendrohet kryesisht në pistoletat dhe pushkët e sulmit, sidomos në ato që janë në duar të civilëve. Ata që posedojnë lloje të tjera të armëve potencialisht më vdekjeprurëse, duke përfshirë snajperët dhe mitralezët, po ashtu duhet të nxiten që t'i këmbëjnë armët vullnetarisht për nisma zhvillimore. Ata që janë përgjegjës për çfarëdo ndërhyrje duhet ta kenë parasysh, sidoqoftë, nivelin e ndryshëm të besueshmërisë ndërmjet popullatës shqiptare dhe asaj serbe. Mbase më e rëndësishmja është se SABA na tregon se përfshirja e udhëheqësisë lokale dhe pjesëmarrja e bashkësive në mbrojtjen e sigurisë së tyre vetjake si dhe nevojat e tyre zhvillimore do të përbëjnë tërësinë e suksesit të çdo AKZh-je të ardhme.

I. Hyrje

Ka më se një dekadë e gjysmë qyshse armët e vogla ndodhen në zemër të trazirave në Ballkan. Një nga imazhet më të frikshme të luftës në Bosnja është ai i snajperëve që vrasin dhe ngulojnë civilët në Sarajevë. Në Shqipëri, ngjarjet më dramatike të viteve 1990 ishin vjedhjet e më se gjysmë milioni armësh të vogla nga depot ushtarake më 1997, si kudërpërgjegje ndaj dështimit të skemave piramidale të kursimeve ku shumë shqiptarë i humbën mjetet e tyre të jetesës. Në IRJM, mënyra se si lufta mezi u shmang më 2001, shpesh ilustruhet me imazhe të opearcionit të udhëhequr nga NATO-ja 'Korrja e domosdoshme'. Në këtë përpjekje grumbullimi të armëve, nacionalistët shqiptarë ua dorëzuan rreth 3.800 armë të vogla dhe të lehta forcave ndërkombëtare. Në Kosovë, luftëtari i armatosur i UÇK-së mbetet figurë e fuqishme e humbjes së durimit të shqiptarëve të Kosovës pas një dekade të represionit të shtuar nga Millosheviqi dhe ithtarët e tij. Të gjitha këto pamje armësh në Ballkan në shumicën e vendeve të tjera të Europës i japin rajonit pamjen e një zone 'të jashtëligjshme', dhe të njerëzve të lidhur fort me armët.

Ky studim shqyrton çështjen e armëve të vogla në Kosovë. Kosova ende njihet nga më se një dekadë e persekutimit mbi baza etnike dhe nga lufta e udhëhequr nga NATO-ja kundër Jugosllavisë së Millosheviqit, që ky persekutim më në fund sollti.³ Kosova mendohet të jetë vatër e shumë armëve, shumë sosh të mbetura nga konflikti i fundit. Sidoqoftë, nuk dihet shumë mbi situatën në Kosovë sa i përket armëve. Sa armë ka? Kush i mban? Si tregtohen? Çfarë efektësh kanë në shoqërinë kosovare, dhe si perceptohen?

Faqe 1

Ky studim mëton të ofrojë disa përgjegje ndaj këtyre dhe pyetjeve të ngjashme. Studimi, zyrtarisht i quajtur Vlerësimi Bazë mbi Armët e Vogla SABA, është komisionuar nga UNDP-ja nën mbikëqyrjen e Projektit për Kontrollin e Armëve të Vogla të Paligjshme ISAC në Kosovë. Studimi është hartuar në veçanti për ta informuar komponentën Armët në Këmbim të Zhvillimit (AKZh) të programit në këtë territor (shih Kutinë 1.1). Kësisoj ai shërben si dokument mbështetës për vlerësimin e zbatueshmërisë së mbledhjes së armëve në Kosovë. Sidoqoftë, ai është vendosur si një dokument referimi mbi armët e vogla përgjithësisht në gjithë këtë territor, dhe kështu i adresohet një publiku shumë më të gjerë.

Kutia 1.1 Gjenerimi i informatave të reja: Të dhënat dhe burimet e studimeve

Ky studim bazohet në një varg materialesh, të mbledhura nga burime si:

- Anketë në amvisëri sy më sy me 1,264 persona e hartuar nga SAS dhe e shpërndarë nëpër Kosovë (për më shumë, shih kutinë 3.1 dhe Shtojcën I dhe II);
- 12 diskutime me grupet e synuara secila me nga 5-11 pjesëmarrës, ndërmarrë në 4 loka-cione (tri me shqiptarë dhe një me serbë) në Kosovë (shih kutinë 3.2);
- intervista me 15 ish-luftëtarë të UÇK-së nga 7 zona operative të UÇK-së
- intervista me 29 mësues dhe administratorë në 15 shkolla nëpër Kosovë;
- intervista me personelin kyç të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse, UNMIK-un, KFOR-in, OSBE-në dhe vepruesit e tjerë në sektorin e sigurisë;
- banka e të dhënave e Policisë së UNMIK-ut (Sistemi për Informim i Policisë së Kosovës, SIPK); dhe
- banka e të dhënave e Spitalit Universitar të Pishtinës.

Seksioni II dhe III i këtij studimi shqyrtojnë kontekstin e përgjithshëm politik dhe ushtarak të situatës së armëve të vogla në Kosovë. Seksioni IV ofron pamje lidhur me numrin e armëve në Kosovë, detyrë e vështirë kjo duke marrë parasysh natyrën e brishtë të kufijve në rajon dhe sigurinë që lidhet me posedimin e armëve. Kufijtë e cenueshem shqyrtohen në Seksionin V, që përdendrohet në tregtimin ilegal me armët e vogla dhe të lehta (AVL). Seksioni VI shqyrton kontekstin kulturor dhe historik të posedimit dhe përdorimit të armëve të vogla në Kosovë, duke përfshirë historinë e grumbullimit të armëve nga Osmanët dhe Jugosllavët. Po ashtu qartëson se si vlerat tradicionale të lidhura me pushkën duhet të transmetohen në kohën e tashme. Seksioni VII vështron më për së afërmi ndikimet e ndryshme që kanë pasur AVL-të në Kosovë, që nga efektet e drejtpërdrejta (vdekja dhe plagosja) te ato të zhdrejta (si krimi, ndikimi në punonjësit humanitarë, dhe në fëmijët në mjedisin e tyre shkollor).

Gjetjet kryesore të raportit janë listuar poshtë.

- Ka afro 330.000-460.000 armë zjarri që mbahen nga civilët në Kosovë. Ky numër bazohet në një nivel prej afro 60 deri në 70 për qind të pronësisë së armëve ndër amvisëritë e këtij territori, dhe në nivelin mesatar të mbajtjeve të armëve ndër këto amvisëri prej rreth 1.4-1.7 armësh. Ky numër përfshin shumicën dërmuese të posedimit të gjithmbarshëm të armëve në këtë territor.
- Llojet më të shpeshta të armëve në Kosovë janë pistoletat dhe pushkët e sulmit. Pistoletat më të shpeshta janë Zastava dhe TT, kurse pushkët e sulmit më të shpeshta janë Kalashnikov dhe Zastava.
- Të dhënat e kapjeve policore tregojnë se Mitrovica dhe Peja janë rajonet më ngjeshur të armatosura se sa Gjilani dhe Prizreni, kurse Prishtina bie në mes. Gjeografikisht, ka më pak armë në qendra urbane sesa nëpër katunde.
- Përveç kriminelëve, duket se biznesmenët dhe ish-luftëtarët janë në veçanti mirë të armatosur. Armët e vogla ose vendosen në vende të veçanta të fshehta në shtëpi, ose varrosen afër shtëpisë.
- Deri më tani amnestive të armëve -ndonëse kjo shpresohet të ndryshojë-u ka munguar adresimi i 'pronësisë' vendase, me pjesëmarrje të kufizuar të politikanëve të Kosovës krahas figurave publike në KFOR-it/UNMIK-ut në përpjekjet për grumbullimin e armëve.
- Grumbullimi i armëve ka qenë më pak i suksesshëm në bashkësitë e serbëve etnikë. Kjo si duket lidhet me perceptimin negativ që ata kanë për ofruesit kryesorë zyrtarë të sigurisë në Kosovë, sidomos në TMK-në, por edhe CIVPOL-in.
- Trafikimi i armëve duket të jetë i kufizuar, sidomos kur krahasohet me format e tjera të trafikimit si kontrabandimi me cigare, me femra dhe me karburante. Trafikuesit e armëve përdorin të njëjtat kanale sikurse edhe llojet e tjera të trafikimit.
- Përpjekjet e paradokohshme për ta rikrijuar një kornizë legislative mbi posedimin dhe transferimin e armëve në Kosovë, dhe sidomos mbi posedimin e armëve të gjuetisë, janë adresuar me sukses, por mbeten ende të pakompletuara deri më sot.
- Lëndimet nga armët e zjarrit kanë rënë dukshëm, duke krahasuar periudhën fill pas luftës (gjysma e dytë e vitit 1999) me vitin 2002.
- Armët megjithatë po mbizotërojnë në krime, dhe janë të pranishme në më se 70 % të të gjitha vrasjeve.
- Armët e krimit janë kryesisht pistoletat dhe Kalashnikovët.

Kutia 1.2 Mbledhja e armëve nga UNDP-ja në Kosovë

UNDP-ja tashmë është sprovuar me kontrollin e armëve të vogla në rajonin e Ballkanit perëndimor: ka organizuar programe të grumbullimit të armëve në Shqipëri (Gramsh dhe më vonë Elbasan, Dibër dhe vendbanime të tjera). Së bashku me Paktin e Stabilitetit, ajo operon në Spastrimoren e Europës Lindore për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta (SEESAC). Për më tepër, ajo tani po fillon me një program në IRJM dhe është duke shqyrtuar edhe një tjetër në Serbinë jugore.

Në Kosovë, projekti i UNDP-së/ISAC mëton ta vetëdijesojë popullatën për problemin e armëve të vogla, t'i mënjanojë armët e paligjshme nga shoqëria, t'i zvogëlojë efektet negative të armëve të vogla, ta nxisë një pjesëmarrje të shtuar në vendim-marrjen politike, ndërkohë që të vazhdojë të promovojë zhvillimin në nivel lokal. Projekti ISAC përbëhet nga këto katër komponenta: 1) Mbështetje për Kornizën Rregullative të Armëve të vogla; 2) Përfshirja e Shoqërisë Civile; 3) Armët në Këmbim të Zhvillimit (AKZh) dhe 4) Shkatërrimi i armëve. Komponenta AKZh do të pilotohet në dy komuna në verën e vitit 2003. Ky do të jetë aplikimi i parë i një modeli AKZh të grumbullimit në Kosovë. Po pati sukses, mund të çojë tek një program i AKZh-së në të gjithë Kosovën. AKZh-ja pilot financohet nga qeveria e Japonisë.

Në fazën e parë, përpjekjet e grumbullimit nën AKZh do të përqendrohen në dy komuna, Vushtrri dhe Viti. Këto janë zgjedhur sipas dy kriterëve objektive:

- (a) *Zbatueshmëria*: gjasat për sukses të programit të AKZh-së në komunë; dhe
- (b) *Rrezikshmëria*: nevoja relative për një program të AKZh-së në një komunë të caktuar.

SAS e ka matur zbatueshmërinë dhe rrezikshmërinë duke përdorë një varg treguesish ekonomikë, politikë dhe socialë, të zbrëthyer sipas komunës. Treguesit janë matur dhe janë llogaritur nëpër indeksat e zbatueshmërisë dhe të rrezikshmërisë. Indeksi i zbatueshmërisë përfshinte nivelet e pjesëmarrjes në zgjedhje, mbledhjen e taksave, si dhe një indeks të përbërë të përgjegjeve të përzgjedhura në një anketë me 1.264 familje (të njohur më mirë si Hulumtimi me ekonomi familjare i SABA-së), të komisionuar nga UNDP/ISAC dhe të kryer në gjithë territorin nga Index Kosova në shkurt të vitit 2003 (shih Kutinë 2.1 për detaje). Indeksi i rrezikshmërisë është kompozuar nga të dhënat mbi nivelet e krimit, kapjen e armëve, trazirat etnike, lëndimet nga armët e zjarrit si dhe disa përgjegje të përzgjedhura ndaj Anketës me Amvisëri e SABA-së. Shtojca 3 liston ndryshoret e indeksave; Shtojca 4 rendon komunat sipas të dy indeksave.

AKZh-ja fton për pjesëmarrje: bashkësitë ftohen të marrin pjesë aktive në program. Një pjesëmarrje e tillë do të shfaqet në faza të ndryshme. Në fazën fillestare, fshatrat dhe lagjet duhet të shfaqin gatishmërinë për të marrë pjesë në program, dhe duhet të bëjnë me dije se sa armë mund t'i mbledhin nga banorët lokalë. Ata po ashtu duhet të dalin me projekte konkrete zhvillimi dhe një propozim për shpenzimin e fondeve zhvillimore që do t'i ofronte UNDP-ja. Procesi është menduar të përfshijë jo vetëm prijësit e bashkësive por edhe grupin përfaqësues të qytetarëve 'të thjeshtë'. Në një fazë të mëvonshme, banorët duhet të mobilizohen aktivisht për t'i dorëzuar armët në mënyrë që ta fitojnë një hise prej fondeve zhvillimore.

Disa analistë kanë shfaqur skepticizëm lidhur me mbledhjen e armëve në Kosovë, duke u shprehur se do të çojë drejt 'një përpjekjeje për t'i mikromenaxhuar disa aspekte të veçanta të sigurisë së ditëpërditshme në Kosovë', e cila nuk mund të ketë sukses 'derisa çështjet themelore politike dhe të sigurisë mbeten të pazgjidhura' (Paes dhe Matveeva, 2003).⁴ Megjithatë, vetëm katër për qind të respondentëve të anketës së SABA-së me amvisëri besonin se armët mbahen për arsye të 'sigurisë politike', ndërsa 69 për qind besonin se armët mbaheshin për arsye të sigurisë personale. Më se 50 për qind të respondentëve po ashtu menduan se ka shumë, ose mjaft, gjasa që njerëzit t'i dorëzojnë armët në këmbim të investimeve në bashkësinë e tyre (shih Shtojcën 1).

II. Kosova: E kaluar e vështirë, e ardhme e paqartë

Kosova është një vend i cënueshem, e rrethuar me fqinjë jostabilë. Ajo vuan nga sëmundje të ngjashme me ato të pjesëve të tjera të Ballkanit - raportet e ndara ndëretnike.⁵ Nga fundi i të 1990-ave, persekutimet e shqiptarëve në Kosovë çuan deri te ndërhyrja e armatosur e NATO-s. Fushata bombarduese e udhëhequr nga NATO-ja, që zgjati nga data 24 mars deri më 2 qershor 1999, nuk i zgjidhi të gjitha problemet, e as nuk iu përgjegj pyetjes për statusin e ardhshëm të Kosovës. Kosova - ndonëse zyrtarisht ende pjesë e shtetit të ashtuquajtur Union i Serbisë dhe Malit të Zi, të mbizotëruar nga Serbia - që nga lufta, ndodhet nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara përmes një Misioni të Përkohshëm Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK). Si rrjedhojë, shqiptarët, që përbëjnë rreth 88 për qind të popullatës në Kosovë, nuk frikësohen më nga represioni etnik. Megjithatë, pjesëtarët e minoritetit serb të Kosovës (rreth 6-7 për qind më 2000)⁶ në pjesën më të madhe, nuk kanë qenë në gjendje të kthehen nëpër shtëpitë e tyre. Për arsye sigurie, enklavat e mbetura të serbëve në Kosovë, në një pjesë janë të izoluar nga pjesa e mbetur e Kosovës dhe të mbrojtur nga forca ndërkombëtare e udhëhequr nga NATO-ja në Kosovë (KFOR).

Përveç frikës nga persekutimi dhe mungesa e mundësive ekonomike, serbët e Kosovës po ashtu ngurrojnë të kthehen në një vend që një ditë mund të bëhet shtet i ndarë me shumë pak lidhje me Serbinë. Duket se janë faktorët 'shtyes' më parë sesa ata 'tërheqës' që nxisin kthimin e serbëve në Kosovë: jeta në qendrat e refugjatëve në Serbi është e vështirë dhe gjasat për të gjetur punë janë shumë të vogla, meqë Serbia mbetet në kriza të thella ekonomike. Deri më sot, vërtet nuk ka shumëçka që t'i 'tërheqë' serbët e Kosovës që të kthehen në Kosovë. Shkalla e papunësisë është shumë e lartë (shih poshtë).⁷ Shtëpitë të shpeshtën u janë shkatërruar, ose janë zënë nga banues të rinj. Procedurat për ta rimarrë pronën janë shumë të ngadalshme, dhe kthimi nga gjyqet nuk po ndihmon për reintegrimin e serbëve të Kosovës në komunitetet lokale. Liria e lëvizjes është shumë e kufizuar, meqë serbët e Kosovës shpesh ngurrojnë të dalin nga enklavat e tyre pa përcjelljen e KFOR-it. Kjo pa dyshim d.m.th. se kontaktet e tyre sociale dhe qasja ndaj kujdesit shëndetësor dhe domosdove themelore të jetës është e kufizuar.⁸

Përpyekjet për ndërtimin e demokracisë në Kosovë po dëshmojnë mjaft të suksesshme. Që nga themelimi i administratës së UNMIK-ut, dy herë janë mbajtur zgjedhjet komunale, më 28 tetor 2000 dhe më 26 tetor 2002. Zgjedhjet gjithëkosovare u mbajtën për herë të parë më 17 nëntor 2001. Gjatë të trija zgjedhjeve, parti të moderuara shqiptare, dhe në veçanti Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e Ibrahim Rugovës, ishin më të suksesshme sesa grupimet më radikale.⁹ Popullata serbe e Kosovës i bojkotoi krejtësisht zgjedhjet e para komunale, dhe pjesërisht edhe zgjedhjet qendrore dhe zgjedhjet e dyta komunale. (ICG, 2001; Bieleley, 2002).¹⁰ Një arsye për këtë ishte se politikanët serbë në Beograd drejt ose zhdrejt i nxitnin të bënin kështu; një tjetër arsye ishte presioni nga disa serbë lokalë në Kosovë, si 'Rojet e urës' (shih poshtë), mbi bashkëkombasit e tyre serbë që të mos votojnë (Paes dhe Matveeva, 2003, f. 38). Megjithatë, më 2002, pjesëmarrja më e madhe në zgjedhje ishte në shumë komuna të përziera, sikur Shtërpca, ku shqiptarët e Kosovës dhe serbët patën frikë nga dominimi i njëri-tjetrit, dhe prandaj u paraqitën në vendvotime në numër të madh (Bieleley, 2002).¹¹

Një numër vendesh në Kuvendin 120-vendesh të Kosovës është rezervuar përgjithmonë për komunitete të ndryshme të Kosovës, duke përfshirë dhjetë vende për minoritetin serb (mbi dhe përveç vendeve që fitojnë në votime).¹² Pas mosmarrëveshjeve politike, kuvendi më në fund e zgjodhi Ibrahim Rugovën si president dhe Bajram Rexhepin si kryeministër në mars të vitit 2002. Pushteti i tanishëm

politik megjithatë, vetëm gradualisht po kalohet nga UNMIK-u drejt organeve të zgjedhura.¹³ Në dhjetor të vitit 2002, një delegacion i Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Kosovë fitoi 'përshtypjen e fortë se pronësia lokale dhe vendosmëria për këto procese [përmirësimi i vendosjes së ligjit, kthimi i grupeve minoritare, privatizimi etj.] ka qenë më i vogël sesa mund të jetë pritur'. Ai e këshilloi UNMIK-un të bëjë përpjekje të mëtejme për t'i përfshirë institucionet vendore dhe udhëheqësit politikë në formimin e politikave dhe zbatimin e tyre (UNMIK, 2003).

Fqinjët e Kosovës po ashtu e ndikojnë stabilitetin e saj. Përtej kufirit verior dhe lindor të Kosovës është Serbia jugore, dhe ka një varg qytezash (posaqerisht Presheva, Medvegja dhe Bujanovci) që kanë shumicë shqiptare. Që nga fillimi i vitit 2000 deri në maj të vitit 2001, shqiptarët etnikë luftuan kundër forcave policore serbe në këtë zonë. Ushtria e shqiptarëve etnikë, e ashtuquajtura UÇPMB (Ushtria Çlirimtare për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanovc), ishte një zgjatim i UÇK-së. Një marrëveshje për paqe që u negociua nga NATO-ja çoi drejt një stabilizimi të përkohshëm dhe të brishtë të situatës. Sidoqoftë, më 2002 pati përtëritje të trazirave në luginën e Preshëvës.

Më 2001, fqinji perëndimor i Kosovës, Mali i Zi, kërcëntonte me shkëputje nga Republika Federale e Jugosllavisë. Situata u zgjidh, të paktën përkohësisht, në mars të vitit 2002, kur BE-ja lidhi një marrëveshje për një union më të zbehtë mes Serbisë dhe Malit të Zi, me emrin e ri Unioni Shtetëror i Serbisë dhe Malit të Zi. Unioni do të vazhdojë të paktën deri më 2006, kur referendumi për pavarësi të mbahet në të dyja rajonet. Sikur Mali i Zi ta kishte braktisur federatën, do të kishte qenë e vështirë të justifikohej mbajtja e Kosovës brenda saj.¹⁴

Nga jug-perëndimi, Kosova kufizohet me Shqipërinë, e cila ka përjetuar periudha të gjata të mungesës së ligjit gjatë këtij 15-vjetëshi të fundit, dhe popullsia e të cilës është ende dukshëm më e varfër sesa ajo simotër në Kosovë.¹⁵ Së fundi, gjatë vitit 2001, IRJM në jug ishte afër një lufte të plotë ndërmjet formacioneve shqiptare dhe aparatit shtetëror të dominuar prej maqedonëve etnikë (formacioni i quajtur UÇK, Ushtria Çlirimtare Kombëtare, ishte përgjegjëse për luftën nga ana e shqiptarëve). Shumë nga luftëtarët shqiptarë thuhet ta kenë përdorë Kosovën si bazë, dhe ende nuk janë çarmatosur krejtësisht.¹⁶ Situata është ende e pazgjidhur dhe ka indikacione (si aktivitetet financuese ilegale dhe manifestimet ekstremiste) se mund të ketë përtëritje të luftimeve në të ardhmen e afërt.¹⁷

Statusi i pazgjidhur i Kosovës - nëse do të mbetet pjesë e Unionit Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi apo do të bëhet e pavarur¹⁸ - i shoqëruar me një urrejtje të fortë ndëretnike, e ka ngadalësuar zhvillimin ekonomik në rajon. Veprimtaria ekonomike është më e fuqishme aty ku prania ndërkombëtare është më e shtuar (industritë shërbyese që i shërbejnë UNMIK-ut, OSBE-së, BE-së, KFOR-it dhe personelit tjetër ndërkombëtar, për shembull), dhe ekziston frika se asnjë lloj i mëkëmbjes së qëndrueshme afatgjate ekonomike nuk po shihet në horizont. Të paktën gjysma e popullsisë jetojnë në varfëri, dhe nivelet e papunësisë janë rreth 50 për qind.¹⁹

Harta e komunave të Kosovës




III. Perceptimet e sigurisë dhe ofruesit e sigurisë

Tipet dhe shkalla e dhunës dhe pasigurisë në Kosovë

Kombinimi i pasigurisë rajonale dhe vendore, tensionet ndëretnike, mungesa e perspektivave ekonomike, si dhe vetë statusi paskonfliktual i kanë kontribuar perceptimit të Kosovës si një shoqëri e dhunshme. Megjithatë, nivelet e raportuara të krimit janë ulur dukshëm gjatë disa viteve të fundit. Më 2001 kishte 89 vrasje (mesatarisht 4,45 për 100.000 banorë), 401 raste plaçkitjesh (20,05 për 100.000), dhe 186 sulme serioze (9,3 për 100.000).²⁰ Këto shifra janë analoge me ato të vendeve të tjera në rajonin e Ballkanit dhe të Europës qendore e lindore; por nëse ka një dallim, ky është se janë më të ulëta. Megjithatë, nivelet e krimit në Kosovë mund të mos figurojnë të sakta në të dhënat zyrtare duke pasur parasysh një ngurrim që kanë qytetarët e saj për ta raportuar krimin në polici.²¹ Përveç raportimit të ulët, një arsye tjetër potenciale për nivele të ulëta të raportimit të krimit është prania e madhe e policisë dhe e ushtrive ndërkombëtare në Kosovë, që zvogëlon nivelet e krimit.

Figura 3.1 shkalla e krimeve në Kosovë në një perspektivë krahasimore



Burimet: SIPK; Interpol; ZSK (2002)

Vrasjet në Kosovë tani bëhen kryesisht ndërmjet meshkujve shqiptarë. Shkalla e vrasjeve ndëretnike ka rënë dukshëm, dhe më pak se një e katërta e viktimave janë femra.²² Në këtë pikëpamje Kosova ndryshon fare pak nga vendet e tjera (për hollësitë e përdorimit të armëve në krime, shih Seksionin VII të këtij raporti).

Një shqetësim për Kosovën sot është se dhuna politike dhe kriminale po ndërlidhen përmes strukturave shumë mirë të organizuara kriminale. UÇK është shpërbërë, një pjesë e udhëheqësisë së saj ka kaluar në

politikë (kryesisht Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, AAK, si dhe Partia Demokratike e Kosovës, PDK), ndërsa të tjerët në biznes, krim të organizuar, ose kanë vazhduar me veprimtaritë paramilitare. Por kjo ndarje nuk është nuk është e plotë, meqë binzasi, krimi i organizuar, si dhe politika ekstremiste ndërlidhen në mënyra të ndryshme. Është me rëndësi të vërehet se kjo nuk kufizohet vetëm te strukturat e ish-UÇK-së. Lidhjet janë më të fortat në organizata ekstreme nacionaliste, të cilat besohet se i financojnë aktivitetet e veta kryesisht përmes krimit, sikurse tash së voni përmes një vargu rrëmbimesh.

Kërcënimi i njerëzve në poste kyçe politike dhe administrative është ai mbizotëruesi. Kjo është dëshmuar nga fakti se është treguar e vështirë të mbahen kosovarët në poste të larta brenda shërbimeve doganore. Lloje të ndryshme të presionit po ashtu ushtrohen nga grupime të ish-UÇK-së. Për shembull, disa herë është pohuar se demonstratat masive të lidhura me UÇK-në (sikur marshi protestues prej 18.000 vetash më 27 shkurt 2003 në Prishtinë kundër dorëzimit të të dyshuarve shqiptarë për krime lufte në Tribunalin e Hagës (TOL, 2003) do të ishte dukshëm më i vogël sikur njerëzit të mos detyroheshin (ndonëse jo domos me kërcënim dhune) që të merrnin pjesë. Një numër eksplozimesh të vonshme që koinciduan me ngjarje të rëndësishme politike kanë shkaktuar disa shqetësime në Kosovë. Sulmi më serioz i kohëve të fundit ishte megjithatë një vrasje. Në janar të vitit 2003, Tahir Zemaj, një komandant i UÇK-së që kishte kaluar në politikë, u qëllua për vdekje bashkë me dy pjesëtarë të familjes së tij (UNDP, 2003, f. 26-7).

Të pyetur në një anketë të periudhës maj-gusht 2002 se sa të sigurt ndjehen në rrugë, 54 për qind të kosovarëve theksuan se ndjeheshin 'mjaft' or 'shumë' të sigurt. Pas tre muajsh, kjo shifër u ngrit në 59 për qind (UNDP, 2003, f. ii). Por, ka dallime etnike në perceptimin e sigurisë. Ndërsa 59 për qind të shqiptarëve ndjehen të sigurt në rrugë, vetëm 41 për qind të serbëve të Kosovës thonë kështu.²³ Ndër serbët, 42 për qind ndjehen 'jo shumë të sigurt' ose 'aspak të sigurt' në shtëpi, ndërsa 26 për qind të shqiptarëve ndjeheshin kështu. (UNDP, 2003, tabela A.8). Megjithatë, ka një ndjesi të përgjithshme brenda popullatës se gjendja e sigurisë po përmirësohet. Të pyetur nga anketa e SABA-së me amvisëritë nëse siguria në zonën e tyre është përmirësuar apo përkeqësuar krahasuar me vitin e mëparshëm, 65 për qind të respondentëve shqiptarë thanë se ajo ishte përmirësuar, dhe vetëm 11 për qind thanë se është përkeqësuar. Ndër serbët etnikë, përgjegjet ishin krejt të ndryshme, me 70 për qind që vlerësonin se situata ka mbetur e njëjtë, 19 për qind që thonin se është përmirësuar, dhe 6 për qind se është përkeqësuar. (shih Shtojcën 1).

Kutia 3.1 Anketa Familjare e SABA-së

Nga 4 deri më 10 shkurt 2003, Index Kosova bëri një anketë amvisërisht sy më sy me 1.264 njerëz në gjithë Kosovën, që u komisionua nga UNDP/ISAC si pjesë e SABA-së. U intervistuan edhe shqiptarët edhe serbët. Tema e anketës ishte siguria dhe armët në Kosovë.²⁴ Anketa përmbante afro 40 pyetje mbi përvojat e kërcënimit, perceptimit të sigurisë dhe mbi ofruesit e sigurisë, qëndrimet ndaj armëve dhe masat e ndryshme për kontrollin e armëve, numrat dhe tipet e armëve që besohet se janë në qarkullim etj. (Disa përgjegje të pyetësorit janë paraqitur në Shtojcën 1 të këtij raporti; pyetësori i plotë gjendet në Shtojcën 2).

Kjo, siç u dëshmuar, ishte temë shumë e ndjeshme. Megjithëse pyetjet janë bërë në mënyrë të zhdrejtë (p.sh. kur respondentit është pyetur për armët në lagje dhe jo për armët e mundshme të veta), kjo ishte hera e parë që Index Kosova u ndesh me refuzime gjatë kryerjes së anketës. Respondentët shpesh pyetnin nëse intervistuesit janë dërguar nga KFOR-i, UNMIK-u, ose ShPK-ja, dhe shprehnin shqetësim se intervistat do të pasoheshin nga bastisjet ose arrestimet.

Përkundër këtyre problemeve gjatë procesit, anketa dha rezultate interesante përfundimtare, sidomos duke shfaqur dallimet ndërmjet bashkësive etnike dhe grupeve të ndryshme demografike (mosha, mjedisi rural/urban, etj.), të cilat janë nënvizuar përgjatë gjithë këtij raporti.

Një tablo më e plotë e arsyeve të pasigurisë është ofruar nga kërkimi i grupeve të synuara pjesëmarrëse i bërë nga Index Kosova për këtë studim në katër vendbanime në Kosovë (Kutia 3.2). Të pyetur për faktorët që shkaktojnë pasiguri, njerëzit nuk përmendnin doemos krimin. Burrat kryesisht theksonin faktorët politikë, siç është statusi final i Kosovës, kontrolli i kufizuar i organeve udhëheqëse, gjykatat jofunksionale, si dhe enklavat, edhe pse vrasjet enigamike, krimi i organizuar dhe droga po ashtu u përmendën. Gratë më tepër përmendën ngasjen e shpejtë e të shfrenuar të veturave,²⁵ rrugët e errëta, mungesën e trotuareve, rrugët e këqija, qentë endacakë, si dhe ndotjen. Trafikimi, krimi dhe dhuna po ashtu u renditën si faktorë që shtojnë pasigurinë. Fëmijët dhe rinia, për dallim, ishin më të shqetësuar nga krimi. Në krye të listës së tyre ishin kriminelët, vrasjet, kontrabanda me drogë, trafikimi i njerëzve, rrëmbimet dhe dhunimet.

Grupet e synuara të serbëve përgjithësisht ishin më të shqetësuar nga krimi sesa shqiptarët, meqë burrat, gratë dhe fëmijët/rinia i cilësonin llojet e ndryshme të krimin (drogat, dhunimet, sulmet ndaj fëmijëve si dhe rrëmbimet) shumë lart në listat e tyre. Burrat në veçanti e shihnin krimin si diçka që vjen kryesisht nga bashkësia tjetër. Serbët po ashtu i cilësuan çështjet si transporti për në enklava dhe jashtë tyre, pavarësia e Kosovës, si dhe centralizimi i Kosovës²⁶ shumë lart në listën e shqetësimeve për sigurinë.

Çështja e armëve erdhi spontanisht në disa nga këto biseda mbi faktorët e pasigurisë. Në Gjilan, një nga faktorët për pasigurinë i përmendur në bisedat me burrat e grupeve të synuara, ishte ai i armëve të palicencuara (megjithëse jo si një nga kërcënimet kryesore). Në Prizren, gratë, burrat, si dhe fëmijët/rinia i listuan armët ndër shqetësimet e veta kryesore për sigurinë. Për gratë, armët e palicencuara ishin shqetësimi kryesor për sigurinë. Fëmijët dhe rinia e Prizrenit i renditën 'njerëzit e armatosur' si të dytët, kurse burrat i renditën 'armët' të katërtat ndër faktorët e rrezikut. Në Mitrovicë (pjesën jugore) dhe në grupet e synuara të serbëve të Kosovës, megjithatë, armët nuk u përmendën. Në përgjithësi, kjo tregon se ka shqetësime të mjaftueshme për praninë e armëve në popullatën e Kosovës. Kjo dëshmohet nga anketa me amvisëri e SABA-së. Të pyetur nëse mendojnë se a ka shumë armë në shoqëri, 47 për qind të nënmostrës së respondentëve shqiptarë dhe 46 për qind të serbëve etnikë u përgjigjën 'po', ndërsa 20 dhe 32 për qind, respektivisht, u përgjigjën 'jo' (shih Shtojcën 1).

Perceptimet e ofruesve të sigurisë

Që të ketë sukses cilido program i grumbullimit të armëve, njerëzit duhet besojnë atyre që janë të ngarkuar me ofrimin e sigurisë për bashkësinë. Të pyetur se kë do ta kontaktonin sikur vetura, moto-cikleta, ose ndonjë tjetër mjet t'u placitej, 90 për qind të respondentëve shqiptarëve të Kosovës thanë se do t'i drejtoheshin ShPK-së, dhe nja 6 për qind të tjerë do të shkonin në CIVPOL.²⁷ Sikur të kërcënoheshin me vdekje respondentët do të bënë njësoj: 87 për qind do të shkonin në ShPK, katër për qind në CIVPOL, dhe tre për qind në KFOR. Në të njëjtën kohë, 30 për qind thanë se kishte 'shumë gjasa' or 'mjaft gjasa' që ta gjuanin/ta sulmonin hajnin po patën mundësi; 38 për qind thanë se ka 'shumë gjasa' ose 'mjaft gjasa' që të kundërviheshin sikur jeta t'u rrezikohej. 80 për qind kishin 'shumë gjasa' ose 'mjaft gjasa' që t'u drejtoheshin të afërmeve, miqve, ose fqinjëve sikur t'u vidhej diçka e vlefshme ose sikur t'i kërcënonin seriozisht. Në rastin ideal, sipas 71 për qind të respondentëve, ShPK-ja duhet të jetë e përgjegjshme për sigurinë. Nëntë për qind besonin se përgjegjësia duhet t'i mbetet KFOR-it, dhe tetë për qind UNMIK-ut/CIVPOL-it (shih Shtojcën 1).

Serbët ishin të prirur pothuajse sa edhe shqiptarët që ose të kundërviheshin /të gjuanin mbi hajnin ose t'u drejtoheshin të afërmeve, miqve, ose fqinjëve. Megjithatë, shumë më pak ishin të prirur që të shkonin tek ShPK-ja: vetëm 13-17 për qind do të shkonin tek ShPK-ja sikur të kërcënoheshin ose t'u vidhej ndonjë gjë me vlerë. Të pyetur, kush, në rastin ideal, do të duhej të ishte përgjegjës për sigurinë, 38 për qind zgjodhën MUP²⁸-in e Serbisë/Policinë serbe/Ushtinë serbe, 28 për qind formacionet militare lokale, dhe vetëm tetë për qind ShPK-në. Këto gjetje i konfirmojnë ato të mëhershmet: në një anketë të nëntorit 2002, më se 95 për qind të shqiptarëve të Kosovës ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me ShPK-në. Më se 78 për qind kishin të njëjtin qëndrim pozitiv ndaj CIVPOL-it. Serbët e Kosovës kanë

opinione krejt të kundërta: më se 90 për qind janë 'të pakënaqur' ose 'aspak të kënaqur' me ShPK-në, dhe 77 për qind kishin të njëjtin opinion mbi CIVPOL-in (UNDP, 2003, f. 27). Pakënaqësia me ShPK-në po ashtu u nënvizua nga fakti se serbët e Kosovës në uniformë të ShPK-së janë sharë e abuzuar gojarisht dhe madje edhe fizikisht në Kosovën veriore (Paes dhe Matveeva, 2003, f. 39-40).

Hulumtimi i grupit të synuar konfirmon këtë, por bën edhe disa plotësime interesante. Meqë diskutimet u përqendruan kryesisht mbi sigurinë dhe jo në mbrojtjen nga krimi, KFOR-i mori një rëndësi më të madhe, sikurse edhe TMK-ja dhe zjarrfikësit në mesin e respondentëve shqiptarë të Kosovës. Edhe familja u cilësua lart ndër ofruesit e sigurisë, sidomos në mesin e grave. Burrat në Gjilan dhe Prizren përmendën 'armët me leje' si ofrues të rëndësishëm, ndonëse jo më kryesorët, të sigurisë. Një shenjë brengosëse është ajo se fëmijët dhe rinia theksojnë vetëmbrojtjen dhe armët vetëmbrojtëse ndër ofruesit e sigurisë. Për pjesëmarrësit meshkuj të serbëve të Kosovës, Armata Jugosllave, Ministria e Brendshme e Serbisë si dhe Policia serbe u cilësuan më së larti ndër ofruesit e sigurisë. Armatimi personal, vetorganizimi, si dhe klubet e gjuetarëve u cilësuan si i teti, i nënti dhe i dhjeti ndër ofruesit e sigurisë për meshkujt serbë në Kosovë. Grupi i synuar i meshkujve po ashtu theksoi se 'sikur t'u jepej rasti që të posedonin armë legalisht, kjo do të ishte shumë mirë për ofrimin e sigurisë së tyre'. Gratë nuk i përmendën armët, por fëmijët dhe rinia serbe në Kosovë, ngjashëm me ata shqiptarë, i renditën armët në krye të ofruesve të sigurisë.

Kutia 3.2 Kërkimi në grupe të synuara në Kosovë

Teknikat e kërkimit të pjesëmarrjes mund të përdoren për të mbledhë informata më të hollësishme mbi një varg temash, duke përfshirë çështje të ndjeshme si çështja e armëve në Kosovë. Në Kosovë, teknikat e kërkimit të pjesëmarrjes, në formën e diskutimeve me grupet e synuara, janë organizuar në katër vendbanime të Kosovës (Gjilan, Mitrovicë jugore, Prizren, si dhe në komunën e Prishtinës; banorët serbë nga Llapnasella, Çagllavica dhe Graçanica). Në secilin lokalitet, pjesëmarrësit u zgjodhën në mënyrë paushalle dhe u ndanë në tri nëngrupe: fëmijë/rini (9-17 vjeç), gra, dhe burra. Index Kosova dhe Gallup International kryen kërkimet pjesëmarrëse, të komisionuara nga UNDP/ISAC, në janar dhe shkurt 2003.

Pjesëmarrësve iu kërkua të bëjnë pesë ushtrime:

1. *T'i emërojnë faktorët e pasigurisë*: Së pari, pjesëmarrësit u lutën t'i listojnë lirshëm të gjithë faktorët që i bëjnë të ndjehen të pasigurt. Si hap i dytë, u kërkua t'i rendisin këta faktorë në çifte. Kështu, u fitua një renditje e faktorëve të ndryshëm të pasigurisë.
2. *Identifikimi i ofruesve të sigurisë*: pjesëmarrësit u lutën t'i listojnë të gjitha institucionet/organizatat/organet të cilave do t'u drejtoheshin sikur të ndjeheshin të pasigurt. Pastaj ata e renditën rëndësinë e ofruesve si dhe afrinë që ndjejnë ndaj tyre.
3. *Siguria hartuese*: Pjesëmarrësit u lutën të vizatojnë një hartë të qytezës/ lagjes së tyre, duke i identifikuar pikat dhe vendet e sigurta dhe vendet ku mund të gjenden armë të vogla.
4. *Vizatimi i një linje kohore (vetëm gratë dhe burrat)*: Pjesëmarrësit u lutën të vizatonin një diagram të asaj se si nivelet e pasigurisë kanë ndryshuar gjatë 10 viteve të fundit, duke shpjeguar uljet dhe ngritjet e diagramit.
5. *Armët e vogla dhe pasojat e tyre*: Pjesëmarrësit u lutën t'i listonin të gjitha llojet e AVL-ve të cilat i kishin parë ose dëgjuar gjatë 12 muajve të fundit. Si hap i dytë, ata i renditën këto armë për të arritur në një listë të tipeve më të rrezikshme të armëve. Së fundi, pjesëmarrësit u lutën t'i listojnë të gjitha ndikimet /pasojat e mundshme të armëve në listë.

Në Kosovë, ka një varg të burimeve të tjera të informacionit në dispozicion të kërkuesit. Teknikat e kërkimit të pjesëmarrjes thuhet se janë më pak të rëndësishme për kërkimin sesa në mjedise me informata të pakta. Megjithatë, siç vërehet nga seksionet e mëposhtme të raportit, kërkimi i pjesëmarrjes në kontekstin e Kosovës është treguar shumë i dobishëm në trekëndëshimin dhe verifikimin e të dhënave që janë fituar me mënyra të tjera.

IV. Sa armë ka në Kosovë?

Mbajtësit e ndryshëm të armëve në Kosovë

Armëmbajtjet e përgjithshme të pandehura nga civilët në Kosovë mund të jenë diku ndërmjet 330.000 dhe 460.000. Pothuajse të gjitha këto mbahen ilegalisht (që nga maji i vitit 2003, vetëm 20.000 armë gjahu janë të regjistruara legalisht).

Ky Seksion detajon se si kjo shifër e pandehur e pronësisë civile është përlogaritur, dhe shpjegon si janë të shpërndara këto armë, gjeografikisht dhe demografikisht. Është me rëndësi të përmendet, megjithatë, se një numër i madh i akterëve të ndryshëm mbajnë armë në Kosovë, dhe se dallimet ndërmjet disave janë të paqarta. Përveç civilëve, në armëmbajtës përfshihen edhe ish-luftëtarët, firmat private të sigurisë, paraushtarakët (qofshin serbë apo shqiptarë), Policia e Kosovës (ShPK), Shërbimi emergjent i Kosovës (TMK), si dhe policia ndërkombëtare dhe forcat ushtarake të pranishme në Kosovë (CIVPOL, KFOR). Në veçanti, është e vështirë të bëhet dallimi ndërmjet armës civile dhe asaj që mbahet nga një individ që lehtë mund të mobilizohet në një grup paramilitar gjatë trazirave politike. Sidoqoftë, skemat e pronësisë së armëve për secilën kategori janë paraqitur ndamas më poshtë.

Armëmbajtjet e përgjithshme të besuara nga kosovarët (pra, duke përfshirë armatimet e jovicilëve sikurse është ai i ShPK-së) mund të përlogariten ndërmjet 350.000 dhe 480.000 armë (shih Tabelën 4.1). Kjo pandehmë prapë i përjashton armët e forcës ndërkombëtare policore (nja 4.300 oficerë të huaj në prill 2003), si dhe ata të KFOR-it (që kishin rreth 28.000 trupa në Kosovë në mars të vitit 2003).²⁹ Shifrat e mësipërme flasin se një shumicë e madhe e armëve të vogla janë në duart e civilëve.

Tabela 4.1 Totali i pandehur i armëmbajtjes nga kosovarët (të ligjshme dhe të paligjshme), 2003

SHPK	TMK	Mbajtës të KAA	Civilë (mbajtje të ligj. e të paligj.)	Formacione serbe në Kosovë	Formacione shqiptare në Kosovë (përfshirë UÇKomb.)	Gjithsej
5,200	200 (+1,800)	200+	330,000- 460,000	240-400	11,800-15,800	350,000- 480,000

Ndryshe nga pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, sidomos Serbia dhe Bosnjë- Hercegovina, nuk ka prodhim vendas të armëve të vogla në Kosovë, përveç ndonjë arme të improvizuar.³⁰

Vendosja e ligjit dhe Armët e TMK-së

Sikur edhe gjetiu, armët për zbatimin e ligjit në Kosovë janë një pjesë e armëmbajtjeve të përgjithshme, me pak më shumë se 5.000 armë.³¹ Me tërheqjen e tyre në qershor të vitit 1999, policia serbe pushoi së qeni organi ligjzbatues në Kosovë.³² Zbatimi i ligjit dhe detyrat e rendit publik janë marrë përsipër nga një organizatë e re, Policia e UNMIK-ut, e cila përfshin CIVPOL-in ndërkombëtar dhe ShPK-në. Ata operojnë nën urdhërin e autoriteteve ndërkombëtare. Megjithatë, në pjesët e serbëve të Kosovës, dhe sidomos në Mitrovicën veriore, CIVPOL-i dhe SHPK-ja janë vetëm pjesërisht efektive. Në vend të tyre 'rendin dhe ligjin' e vendosin struktura jozyrtare paraushtarake, siç janë 'Rojet e Urës' (armëmbajtjet nga struktura të tilla si kjo diskutohen në Seksionin V). ShPK-ja është një organizatë policore me fuqi të personelit prej 5.185 oficerë në janar të vitit 2003.³³

Sipas burimeve të UNMIK-ut, ata mbajnë gjithsej rreth 5.200 armë, kryesisht armë anësore (pistoletat Glock 9mm), por po ashtu 75 AK-47s për partollime në kufi dhe 32 H&K MP-5s për mbrojtje së afërmi.³⁴ Përmirësimi i armatimeve të rojeve kufitare është përgjegje ndaj trafikantëve të armatosur mirë që kalojnë kufirin. Zgjedhja e AK-47-ve është nxitur nga kapjet e armëve, që përbëhen kryesisht nga AK-të. Parandaj është kjo një mënyrë e lirë për ta pajisur policinë. Me pak më pak sesa një armë zjarri për oficer, SHPK-ja është paksa më dobët e armatosur sesa shumë kolegë të saj të huaj: një shumëzues tipik i armatimit të policisë me 1.2 armë zjarri dhe armë të lehta për çdo oficer të betuar do të jepte një inventar prej rreth 6.200 armësh.³⁵

E krijuar në këmbim të demobilizimit të UÇK-së, Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), ka një anëtarësi prej 3.000 vetash dhe një degë ndihmëse prej 2.000 meshkujsh e femrash. Ajo është përgjegjëse për ndihmë gjatë katastrofave, për operacione kërkimi dhe shpëtimi, sikurse janë ato të bëra pas tërmetit në prill të vitit 2002 në Gjilan, me ndihmesë në çminim, ndihmë në asistencë humanitare nëpër zona të largëta, dhe me rindërtimin pas luftës. Ajo nuk ka rol në vënien e ligjit apo të detyrave të rendit dhe ligjit. TMK-ja vazhdon të shihet me dyshim në qarqet ndërkombëtare në veçanti, e quajtur nga shumëkush si një punë ditore për një organizatë rebele që ka namën e të marrurit me krimin e organizuar (Davis, 2002, f. 14-15). E ngarkuar ekskluzivisht me përgjegjësi për katastrofa dhe ndihmë humanitare, ajo është supozuar të operojë e paarmatosur, por i lejohen 200 armë për t'i mbrojtur objektet e veta. Sikurse edhe të SHPK-ja, këto janë kryesisht armë anësore dhe AK-47s.³⁶ Përveç këtyre armëve TMK-së i lejohet të mbajë edhe një numër të vogël armësh ceremoniale dhe, ç'është më e rëndësishmja, KFOR-i mban 1.800 armë të vogla në mirëbesim për TMK-në.³⁷ Sot, këto armë janë në kondita mjaft të këqija. Edhe pse TMK ka të drejtë për një qasje ndaj këtyre armëve me mbikëqyrjen e KFOR-it, kjo organizatë nuk është duke i mirëmbajtur. Kjo mund të nënkuptojë se TMK-ja, e cila rreket të bëhet armatë kombëtare në rast se Kosova një ditë bëhet e pavarur, nuk ka mungesë të armëve me cilësi dhe fuqi më të mirë, ose qasje të gatshme ndaj armëve të tilla.

Megjithatë, a mban TMK-ja si organizatë ndonjë arsenal të fshehur të vetin, nuk dihet. Ka më shumë gjasë që disa pjesëtarë individualë të saj, ose grupe anëtarësh, të kenë qasje të lehtë ndaj armëve (megjithëse si pjesëtarë të TMK ballafaqohen me masa ndëshkimore më të mëdha sesa civilët e rëndomtë nëse armët u kapen në posedim).

Pjesët e tjera të sektorit të sigurisë në Kosovë po ashtu mbajnë armë, por në sasi të vogla. Rojet e burgut që i patrollojnë muret e burgut të sigurisë së lartë në Prishtinë janë të armatosur me AK 47, meqë ka pasur tentativa për të thyer burgun dhe për të hyrë në të si dhe për të ikur prej tij. Zyrtarët e doganave nuk janë të armatosur, edhe pse njësitë e tyre lëvizëse (që kryesisht e luftojnë trafikimin e cigareve) do të pajisen me armë jovdekjeprurëse në të ardhmen.³⁸

Përveç strukturave publike të sigurisë, ka disa kompani private të sigurisë që po ashtu kanë armë. Ato që operojnë legalisht mund të aplikojnë për Kartën e Autorizimit të Armëve (KAA, shish Seksionin VI për hollësi) nga UNMIK-u. Ka shumë gjasë që personeli i sigurisë, të cilët përfitojnë nga zona e hirtë mes legales dhe jolegales, të kenë qasje ndaj një vargu armësh të vogla.

Armatimet e formacioneve

Niveli i armatimit të formacioneve militare në Kosovë është vështirë të përcaktohet, për dy arsye. E para, luftëtarët shqiptarë do të mundeshin, dhe ende munden, t'i lëvizin operacionet e tyre me mjaft lehtësi ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe disa pjesëve të IRJM-së. Ky fleksibilitet i tejkalon ndarjet territoriale të armëmbajtjeve, dhe tregon për nevojën e një përlllogaritjeje rajonale ose të bazuar në

burime paramilitare të stoqeve. E dyta, dallimi ndërmjet luftëtarëve dhe civilëve është i mjegullt, duke e penguar kështu shquarjen e armatimeve civile prej atyre të formacioneve. Kjo vlen edhe për formacionet militare shumë më të vogla të serbëve të Kosovës.

Tabela 4.2 Armatimet e formacionit të UÇK-së dhe atyre të serbëve të Kosovës në 1999

Formacionet e UÇK -së	Formacionet serbe
32,000-40,000	9,900-13,800

Vlerësimi historik i shkallës së armatimit të UÇK-së komplikohet për shkak se është e panjohur madhësia përfundimtare e UÇK-së në vitin 1999 e po ashtu edhe për shkak se ka disa argumente të ndryshme lidhur me atë se sa ka qenë e armatosur në atë kohë. Vlerësimet për periudhën e qershorit të vitit 1999, pak para se Slobodan Millosheviqi të kapitullonte para kërkesave të NATO-s, ndryshojnë prej një shifre të ulët prej 8.000-10.000 (Small Arms Survey, 2002, f. 290) deri në një numër të gjithmbarshëm të 20.000 kryengritësve në radhët e UÇK-së (Heinemann-Grüder dhe Paes, 2001, f. 14). Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) ka marrë 25.723 aplikacione për ndihmë në riintegrim kur nisi me regjistrimin e luftëtarëve të UÇK-së kah fundi i vitit 1999 (Heinemann-Grüder dhe Paes, 2001, f. 14). Sipas vlerësimeve të KFOR-it, në vitin 1998 në kulmin e luftimeve ka pasur dikund rreth 15.000 pjesëtarë të UÇK-së, që duket se konfirmon shifrat më të mëdha prej rreth 20.000 luftëtarëve të UÇK-së në vitin 1999 (numri i forcave duket se shtohet me rritjen e gjasave për fitore).³⁹ Për këtë arsye, vlerësimi për dikund rreth 20.000 pjesëtarë të UÇK-së është i arsyeshëm.

Faqe 13

Nuk është e qartë se a kanë qenë të armatosur të gjithë luftëtarët dhe çfarë armësh kanë pasur (posaçërisht këta që janë bashkangjitur më vonë). Duket, megjithatë, se posedimi i AVL-ve ka qenë një shenjë e rëndësishme, bile edhe për ata që shumë pak kishin marrë pjesë në luftime. Sipas një luftëtari të intervistuar të UÇK-së, 'armët e lehta ...përdoreshin nga disa njerëz për të shitur mend si ish-ushtarë të UÇK-së edhe pse këta kishin hyrë në radhët e UÇK-së shumë vonë ose edhe kishin hyrë në UÇK mbas luftës.⁴⁰

Duke e përdorë si pikë nismëtare "shumëzuesin e kryengritësve" konservativë nga Anketa e armëve të lehta të 1.6 armëve për luftëtar (shih Kutinë 4.1), arsenali i përgjithshëm i UÇK-së në fund të luftës në qershor 1999 fillimisht mund të vlerësohet se ka qenë dikund rreth 32.000 armë të vogla e të lehta. Një faktor që mund të shtojë përqindjen e armëve kundrejt luftëtarëve është plaçkitja e depove të armëve të Shqipërisë fqinje nga popullata e shqetësuar në vitin 1997 (shih Kutinë 4.3 për hollësi). Si pasojë, UÇK pothuajse sigurisht u shndërrua në një lëvizje guerile të pajisur mirë: shumë njerëz thonë se vetëm mbas ngjarjeve të vitit 1997 në Shqipëri, UÇK-ja u shndërrua në forcë ushtarake serioze. Kjo konfirmohet nga intervista e ndërmarrë për këtë raport me 15 ish-pjesëtarë të UÇK-së. Derisa shumica e të intervistuarve kishin mendimin se gjatë periudhës deri në vitin 1997 ishin marrë shumë pak armë, nëntë nga 15 ish-pjesëtarët e intervistuar të UÇK-së bënë me dije se Shqipëria ishte kanali më i rëndësishëm i armëve pas 1997-ës. Një prej ish-luftëtarëve të UÇK-së i përshkruan rrugëtimet për marrjen e armëve:

Atje shkonim në grupe të ndryshme, nganjëherë kishte grupe të mëdha me 50 deri në 300 njerëz e nganjëherë shkonim në grupe të vogla prej pesë deri në 20 njerëz... Në katundet e veriut të Shqipërisë ... ngarkonim armët (zakonisht AK-47, MD dhe sasi më të vogla të mortajave dhe topave fushorë) dhe municionin në shpinë; e po ashtu ngarkonim kuajt dhe gomarët. Mandej ktheheshim prapë në atë rrugë me plot rreziqe e vështirësi fizike.⁴¹

13 nga të intervistuarit përmendin Shqipërinë, së bashku me Serbinë, Bosnjen e Hercegovinën, Kroacinë dhe IRJM-në, si vendet ku janë blerë armët. Të intervistuarit besojnë se UÇK-ja kishte marrë shumë pak armë nga forcat serbe gjatë luftimeve, përafërsisht 1.5-2 për qind të numrit të përgjithshëm të armëve të UÇK-së. Për dallim prej kësaj, sipas ish-pjesëtarëve të intervistuar të UÇK-së, armët e blera nga burimet në Serbi përbënin 5-25 për qind të të gjitha armëve të UÇK-së.

Nëse e marrim parasysh plaçkitjen e arsenaleve të armëve të Shqipërisë, shumëzuesi i kryengritjes ndoshta duhet shtyrë deri në dy apo më shumë armë për secilin luftëtar. Kjo d.m.th. se armët e UÇK-së numëronin rreth 40.000 ose më shumë armë në vitin 1999, që jep numrin prej 32.000-40.000 armëve të shënuara në Tabelën 4.2.

Sipas marrëveshjes së saj fillestare me KFOR-in, UÇK-ja u pajtua që brenda 90 ditëve t'i dorëzojë të gjitha armët përveç atyre joautomatike me tytë të shkurtër.⁴² Gjatë periudhës 90-ditëshe, UÇK-ja dorëzoi rreth 8.500 armë zjarri dhe sasi të mëdha të armëve të tjera, përfshirë: afro 7.000 pushkë (3.000 pushkë automatike, 2.000 gjysëm-automatike dhe 2.000 të thjeshta), përafërsisht 300 armë anësore (të shumtën pistoleta gjysëm-automatike), 700 mitralozë (shumica të lehtë), 200 mortaja, rreth 300 armë antitank, më pak se 20 armë për mbrojtje ajrore, 27.000 granata dhe më shumë se 1.200 mina. Për më tepër, u dorëzuan më shumë se gjashtë milionë rrahë municioni të AVL-ve. Konfiskimi nga UÇK-ja nisi gjatë këtyre 90 ditëve dhe pati si rezultat grumbullimin e më shumë se 1000 pushkëve, gati 400 pistoletave dhe revoleve dhe diçka më pak mitralozëve, armëve antitank, granatave, minave dhe municionit.⁴³

Page 14

Shifrat relativisht të vogla të armëve të dorëzuara nga UÇK-ja, komandanti i UÇK-së i pati shpjeguar me këto fjalë:

Në fund të fushatës së bombardimeve kishim 20.000 ushtarë, por shumë prej tyre, ndoshta edhe 50 për qind, ishin rekrutuar dhe nuk kishin armë. U duhej ta ndanin një armë. Asnjëherë nuk na mungonin luftëtarët por kishim problemin e armëve - si me sasinë ashtu edhe me cilësinë e tyre. (Cituar në Heinmann-Grueder dhe Paes, 2001, f. 19.)

Sidoqoftë, shumica pajtohen se UÇK-ja nuk është çarmatosur plotësisht (Ripley, 2000, f. 21; Heinmann-Grueder dhe Paes 2001, veçanërisht f. 19-21), diçka që e tregojnë edhe vlerësimet e bëra më lart: po të ishte e vërtetë se UÇK-ja me të vërtetë ka pasur rreth 32.000-40.000 armë, dhe vetëm rreth 10.000 i ka dorëzuar (8.500) ose janë marrë prej tyre (1.500) gjatë 90 ditëve, kjo do të thotë se nuk dihet edhe për së paku 22.000-30.000 armë.

Pra çështja mbetet: çka ndodhi me pjesën e mbetur të armëve? Sot UÇK nuk ekziston më si një grup i vetëm: dhe siç është thënë në Hyrje, disa ish-luftëtarë të UÇK-së i janë bashkangjitur TMK-së, kanë hyrë në politikë, biznes, krim të organizuar ose thjesht i janë kthyer jetës civile. Pra ka gjasë që armët e UÇK-së të jenë nën kontrollin e grupeve dhe individëve të ndryshëm. Sipas disa analistëve, disa nga armët e mbetura janë deponuar në Shqipëri (Ripley, 2000, f. 22; Heinmann-Grüder dhe Paes, 2001, f. 20). Ekziston mundësia që ka deponi të mëdha armësh përtej kufirit lindor të Kosovës në Shqipëri e përreth vendeve si Buçaj dhe Krumë, por këto armë nuk janë trajtesë e këtij raporti.⁴⁴ Sidoqoftë, këto do të paraqisnin një shqetësim serioz sikur të nisnin prapë konfliktet e armatosura.

Megjithatë, grumbuj të mëdhenj të armëve ende gjenden anembanë Kosovës, dhe disa prej tyre janë në asi gjendje që të bënë të besosh se thjesht janë harruar. Të tjerat as që janë ruajtur në ndonjë mënyrë.⁴⁵ Shpalljet për kapjen e grumbujve të armëve janë gati të përditshme në komunikatat e shtypit nga KFOR-i. Kështu për shembull, komunikata e shtypit e 7 marsit 2003 shpalli se ushtarët e batalioneve

finlandeze dhe norvegjeze kanë zbuluar një sasi 'të bollshme' në rajonin e Fushë Kosovës, që përmbante 32 granata dore, 13 pushkë, 4.434 rrathë municioni të armëve të vogla, 400 gramë të TNT-së, 1 kg të eksplozivit plastik, 38 arka armësh dhe 5 granata pushkësh. Të njëjtën ditë u zbuluan sasi më të vogla armësh dhe eksplozivash në afërsi të Vidomirovicit, Ugdares, Mitrovicës dhe Podujevës (KFOR, 2003).

Pa dyshim se disa nga armët e UÇK-së janë bartur në UÇPMB (fraksion nga UÇK-ja që luftonte me policinë serbe në Serbinë jugore), që në vitin 2000 kishte rreth 2.200 pjesëtarë,⁴⁶ kur luftimet në Serbi jugore ishin në kulmin e vet. Sot, numri i luftëtarve sigurisht është pak më i vogël, ndoshta rreth 1.000. Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK), që luftoi për ndarje etnike të IRJM-së në vitin 2001, raportohet të jetë së paku pjesërisht e bazuar në Kosovë dhe e varur nga vendet e sigurta përreth territorit. Madhësia e përgjithshme e UÇK-së është vlerësuar të jetë përafërsisht rreth 1.500-2.000 pjesëtarë aktivë në vitin 2001.⁴⁷ Prapë, duke e përdorë shumëzuesin aktiv të kryengritjes prej 1.6 armësh për luftëtar (shih Kutinë 4.1), si dhe shifrën më të lartë prej 2.0 armësh për luftëtar, bazuar në shpërndarjen e armëve në rajon, madhësia e deponimeve të armëve të UÇK-së mund të vlerësohet në rreth 2.400-4.000 AVL. Grupet tjera fraksione të UÇK-së, si Armata Kombëtare Shqiptare, (AKSh), UÇPG, dhe UÇK-L së bashku vlerësohet të kenë pasur 4.900 pjesëtarë në vitin 2001,⁴⁸ që d.m.th. një numër i madh i ish-armatimit të UÇK-së, 7.800-9.800 armë, mund të kenë përfunduar në duart e këtyre grupimeve /organizatave.

Të bëra bashkë, këto llogaritje sugjerojnë se grupet paramilitare të shqiptarëve të Kosovës, përfshirë edhe Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare mund të kenë rreth 11.800 dhe 15.800 armë, shifra e dhënë në Tabelën 4.1. Armët e mbetura të ish-UÇK-së, rreth 8.000 dhe 18.000 armë, supozohet se tashmë janë pjesë e arsenalit të armëve që mbahen nga civilët.

Grupet paramilitare të serbëve të Kosovës ishin mjaft të forta në vitin 1999. 'Dora e zezë' kishte dikund rreth 700-1.000 pjesëtarë, Armata Çlirimtare Serbe (OSA) dikund rreth 5.000 dhe 'Shqiponjat e bardha' 500-900 luftëtarë.⁴⁹ Sipas informatave të marra nga SAS, këto ishin të armatosura mirë prej Ushtrisë Jugosllave (AJ) dhe prej policisë së Jugosllavisë. Kjo d.m.th. se në vitin 1999 paramilitarët serbë të Kosovës kishin së paku $1.6 \times (700+5000+500) \sim 9,900$ armë. Është më e besueshme se përqindja e armëve për krye luftëtari ishte më e madhe duke e pasur parasysh taktikën e 'luftës popullore' të ushtrisë jugosllave.⁵⁰ Nëse e përdorim shumëzuesin e dy armëve për luftëtar dhe numrin më të lartë të militantëve, numri i përgjithshëm del 13.800 AVL. Sot, këto grupe paramilitare janë tkurrë në një grusht grupesh të vogla që kryesisht veprojnë në Mitrovicë, siç janë p.sh. 'Rojet e urës'. KFOR-i vlerëson se këto nuk kanë me tepër se 150-200 njerëz gjithsej.⁵¹ Edhe pse tash këta më nuk mbajnë armë haptazi kur janë 'në detyrë', 'Rojet e urës' kanë qasje të mirë ndaj armëve. Në ndeshjet me policinë e UNMIK-ut dhe me KFOR-in, ata përdorën granata dore dhe pushkë sulmi (kryesisht AK-47 të prodhimit serb) (Paes dhe Matveeva, 2003, f. 40). Po e përdorim të njëjtin shumëzues si më parë, 'Rojet e urës' do të kishin dikund rreth 240-400 armë. Duke e pasur parasysh faktin se këta mund të llogarisin në një numër të madh vullnetarësh (deri në 5.000 sipas disa burimeve), numri i përgjithshëm i armëve të tyre sigurisht se është shumë më i madh. Është vështirë të vlerësohet se çfarë lloj përqindjeje e armëve të grupeve militare që tash janë shuar ende ka mbetë në Kosovë, pasi që këto grupe nuk ishin vendase por ishin paramilitare pan-serbë. Megjithatë, për të njehësuar kemi supozuar se këto armë (me përjashtim të armëve të 'Rojeve të urës') ose janë pjesë e stokeve të civilëve ose nuk janë në Kosovë.

Kutia 4.1 Armëmbajtja e vlerësuar

Disa prej shifrave në këtë kapitull janë të sakta dhe të bazuara në të dhëna që janë dhënë nga SAS-i. Disa prej shifrave megjithatë, si p.sh. numri i armëve në pronësi të civilëve, nuk dihen mirëfilli dhe duhet të vlerësohen. Paraprakisht, SAS-i ka krijuar teknika për vlerësimin e numrit të armëve në shoqëri apo në grupe shoqërore. Teknikat kryesore janë metoda e 'marrjes' dhe metoda e 'posedimit'.

Qasja e marrjes është e bazuar në premisën se mund të jepet një pasqyrë e saktë e numrit të armëve në një vend të caktuar në kohë të caktuar (p.sh. në vitin 1990, kur nisi të shturrej Jugosllavia), dhe se marrja e armëve nga të gjitha palët në atë kohë mund të detajizohet. Në Kosovë, është vështirë të përdoret kjo qasje. Në rastin më të mirë marrja e armëve nga UÇK-ja, paramilitarët serbë të Kosovës dhe nga civilët nuk është e dokumentuar mirë. Edhe më me rëndësi është se nuk ka pikë nisjeje, (një moment i caktuar kohor për të cilin ekziston një vlerësim i mirë i numrit të armëve) prej të cilës do të mund të nisnim të llogarisim se kush sa armë ka marrë.

Për këto arsye, raporti kryesisht përdor qasjen e posedimit. Kjo metodë vlerëson numrin e armëve në bazë të numrit të luftëtarëve, civilëve, policëve etj. dhe shumëzuesin për armëmbajtje për secilin grup. Për shembull, nëse e dimë se ka 5.000 policë në Kosovë, dhe besojmë se mesatarisht mbajnë 1.2 armë secili, numri i përgjithshëm i armëve që i mban policia mund të vlerësohet në rreth 6.000.

E si përcaktohen shumëzuesit? Edhe pse qasja e marrjes nuk mund të përdoret lehtë si një metodë e gjithmbarshme në Kosovë, ajo hyn në ekuacion kur bëhet përcaktimi i asaj se sa janë mirë të armatosura grupet paramilitare, e për këtë edhe na del përqindja armëve për luftëtar. Kjo përqindje bazohet në vlerësimin e rëndësisë së hyrjes së armëve (shih Seksionin IV për hollësi).

Një mënyrë tjetër e përcaktimit të shumëzuesit është me anë të ekstrapolimit: nëse dihet se numri i armëve për krye polici në Kanadë është 1.2, mund të supozohet se përqindja është e njëjtë në të gjitha vendet tjera të krahasueshme (shtetet demokratike perëndimore). Kjo metodë përdoret këtu për të përcaktuar numrin e armëve të mbajtura nga paramilitarët. Nga puna e mëhershme, SAS ka krijuar një shumëzues aktiv për paramilitarë prej 1.6 armëve për luftëtar (shih Small Arms Survey, 2001). Këtë numër e kemi përdorë më herët.

Një mënyrë tjetër është që përqindjet të përcaktohen nëpërmjet anketave: njerëzit pyeten se sa armë kanë dhe kjo përqindje mandej zbatohet për tërë popullatën. Kjo metodë nuk është treguar e dobishme në Kosovë (shih më poshtë).

Armatimet e civilëve

Të dhënat zyrtare nga Jugosllavia federale për armëmbajtjen e armëve të zjarrit në vitin 1989 tregonin se Kosova atëherë kishte gjithsej 65.540 armë të mbajtura me leje, ose 4.1 për 100 banorë (Gorjanc, 2000, Tabela 4). Po të ndiqte Kosova rrugën e Jugosllavisë si tërësi, këto armë me leje do të përbëheshin nga pistoletat (56 për qind) dhe pushkët (44 për qind) (kalkuluar nga Gorjanc, 2000, Tabela 2). Kjo përqindje prej 4.1 armësh për 100 banorë ishte mesatarja më e ulët e të gjitha rajoneve në Jugosllavi,⁵² dhe është vështirë të bëhet njësh me faktin se është vërejtur një pronësi e madhe e armëve në krahinë. Të njëjtin vit, policia federale e atëhershme vlerësoi se më shumë se 800.000 AVL ishin të paregjistruara në Jugosllavi si tërësi dhe u raportua se gjysma e këtyre (400.000) ishin në pronësi ilegale në Kosovë (Gorjanc, 2000, f. 10).⁵³ Nëse janë të sakta, këto shifra sugjerojnë se shqiptarët e Kosovës nuk kanë qenë

të gatshëm të regjistrohen, apo janë penguar t'i regjistrojnë armët e tyre masivisht.

Është vështirë të gjykohej se në çfarë mase këto deklarata janë propagandë politike e sa të vërteta. Ajo që është e qartë është se në shtypjen e shtuar të 1990-ave, policia dhe ushtria serbe nisën zbulimin e armëve të mbajtura pa leje (shih Seksionin V për hollësi). Pasi që këto shifra jugosllave mbi armët e regjistruara dhe të paregjistruara nuk janë aspak të besueshme, duhet të gjejmë ndonjë mënyrë tjetër për të vlerësuar numrin e armëve të mbajtura në shtëpitë kosovare.

Një instrument i dobishëm është e ashtuquajtura qasje e posedimit (shih Kutinë 4.1). Kjo qasje e bën vlerësimin e numrit të armëve duke u bazuar në numrin e luftëtarëve, policëve apo, - si në këtë rast - të civilëve dhe të përqindjes së armëve që i posedojnë këto lloje grupesh.

Në Kosovë, armët mbahen si pronë familjare. Edhe pse kontrollohen nga meshkujt e rritur të shtëpisë, ato janë 'armë familjare' e jo individuale. Njësia bazë për të cilën bëhet vlerësimi në këtë rast është familja. Në Kosovë, ka dikund rreth 390.000 amvisëri.⁵⁴ Sa prej këtyre amvisërive mbajnë armë dhe sa armë kanë mesatarisht familjet që mbajnë armë?

Një mënyrë për t'i dhënë përgjegje këtyre pyetjeve është përmes anketave. Respondentët pyeten nëse ata (ose njerëzit në fqinjësi të tyre) mbajnë armë dhe, nëse po, sa armë kanë. Në Kosovë, kjo strategji nuk pati sukses. Kur i pyetëm, 'Sipas jush, sa familje në fqinjësinë tuaj kanë armë?', 43 për qind e të gjithë respondentëve u përgjegjën se nuk e dinin dhe gjashtë për qind të tjerë refuzuan të përgjegjen. Refuzimi ishte shumë i lartë (57 për qind) në mesin e serbëve të Kosovës. Vetëm gjithsej pesë për qind besonin se gati të gjithë, shumica apo çdo e dyta familje mban armë.

Faqe 17

Në të njëjtën kohë, duke dhënë përgjegje në pyetje më të tërthortë, 11 për qind e respondentëve besonin se kishte tepër armë nëpër familje. Gati gjysma e respondentëve mendonin se kishte tepër shumë armë në shoqëri (krahasuar me 20 për qind të shqiptarëve të Kosovës dhe 32 për qind të serbëve të Kosovës, të cilët besonin të kundërtën).⁵⁵ Këto përgjegje janë tregues të mirë të asaj se mund të jetë e ndieshme çështja e mbajtjes së armëve. Megjithatë, këto nuk ndihmojnë në krijimin e një vlerësimi të saktë të armëmbajtjes.


Një metodë tjetër e vlerësimit të armëmbajtjes është që të hulumtohen rezultatet e bastisjeve paushalle të ndërmarra nga KFOR-i.⁵⁶ Tash më nuk bëhen bastisje të tilla dhe nuk ofrohen rezultatet e këtyre bastisjeve si në vitet 1999 dhe 2000.

Një mënyrë tjetër e vlerësimit të numrit të armëve janë vlerësimet e informuara të njerëzve që punojnë në degë të ndryshme të sektorit të sigurisë në Kosovë (kosovarë si dhe ndërkombëtarë që punojnë për UNMIK-un dhe KFOR-in). Në intervista, përgjegjet treguan se 60-70 % të familjeve mbanin armë.⁵⁷ Derisa besohet se shumë familje mbajnë një armë, një pjesë e madhe besohet se kanë dy apo më shumë armë të vogla (të shumtën përzierje të pistoletave, pushkë sulmi dhe armë të gjuetisë). Mesatarisht, me anë të metodës konservative vlerësohet se familjet që mbajnë armë kanë 1.4-1.7 armë. Kjo jep shifrën prej rreth 330.000-460.000 armëve që i mbajnë civilët në Kosovë.

Është e mundshme të fitohet një pasqyrë e llojeve më të zakonshme të tipeve dhe prodhimeve të armëve duke i parë ato armë që janë mbledhur dhe marrë nga Policia e UNMIK-ut dhe në masë më të vogël nga KFOR-i.⁵⁸ Sipas statistikave të policisë, si ajo e dhënë në Figurën 4.1, 44 për qind të të gjitha konfiskimeve përbëhen nga pistoletat, 20 për qind nga pushkët e sulmit, 15 për qind nga pushkët dhe 15 për qind nga pushkët klasike. Pasqyra e fituar nga konfiskimet e policisë është paksa më tjetër nga shprehëdarja e armëve të konfiskuara nga KFOR-i, pasi që policia kryesisht nuk merr armë nga depot ose nga grumbullimet e tjera të tipit ushtarak, por nga zonat e banuara, veturat etj. Pasi që të dhënat

e policisë japin pasqyrë të armëve të kapura lidhur me krimet ose krimet e dyshuara, përfshirë edhe disa krime të padhunshme dhe të paorganizuara siç janë kundërvajtjet e trafikut, ato japin një pasqyrim më të mirë të armatimit të përgjithshëm të civilëve dhe për këtë arsye edhe janë përdorë këtu.

Figura 4.1 Tipet e AVL-ve të kapura nga policia, 2000-2002




*të tjera' përfshijnë kryesisht pushkët ajrore, granatat, snajperët ajrorë.

Burimi: SIPK

Page 18

Figura 4.2 Prodhuesit e pushkëve sulmuese




shënim: Kategoria 'Kallashnikov' mund të përmbajë një numër të modeleve jo-Kallashnikov, duke përfshirë modelin Zastava, meqë familja AK-47 është produkt i shumë prodhuesve dhe shumë prej tyre kanë ngjashmëri të mëdha në dukje, prandaj shpesh i përvishen përshkrimit si 'Kallashnikov'.

*të tjera' përfshin modelet Colt dhe SKS (Simonov)

Burimi: SIPK

Figura 4.3 Prodhuesit e pistoletave



*të tjera' përfshin modelet Mauser, SIG, Smith dhe Wesson, Valro, PM (Makarov), asi dhe Erma-Werke.


Burimi: SIPK

Statistikat e policisë po ashtu e bëjnë të mundshme analizën e shpërndarjes së prodhimeve të armëve të kapura (Figurat 4.2 dhe 4.3). Pushkët e sulmit të kapura janë kryesisht Kallashnikovë, e Zastavat vinë të dytat, por shumë larg mbas tyre. Stoqet e pistoletave që mbahen në Kosovë janë më të fragmentuara. Zastava mban pjesën më të madhe, me gati 40 për qind të të gjitha pistoletave të kapura nga Policia e UNMIK-ut. TT-të (Tokarevët) janë të dytat, derisa Beretat, CZ-të dhe Glockët së bashku po ashtu përbëjnë një pjesë të madhe të pistoletave që gjenden në duart e civilëve të Kosovës. Kjo është me rëndësi sepse tregon se pistoletat ofrohen nga disa burime të ndryshme, që ndoshta tregon natyrën e shpërndarë të kontrabandimit të armëve për civilët.

Faqe 19

Duke pasur parasysh përmasat relativisht të vogla të Kosovës, parimisht shpërndarja gjeografike e AVL-ve mund të ndryshojë shpejt. Për këtë arsye, disa analistë besojnë se të gjitha pjesët e Kosovës, përveç Prishtinës ku prania e sigurisë ndërkombëtare është posaçërisht e dendur, kanë nivele të ngjashme të armëmbajtjes nga civilët.

Analiza e shpërndarjes gjeografike të armëve të kapura nga Policia e UNMIK-ut shkon ndesh me këtë gjetje (Figura 4.4). Krahasuar me shpërndarjen e popullatës, Gjilani dhe Prizreni nuk shfaqen aq shumë për sa i përket armëve të kapura, përderisa Mitrovica dhe Peja janë të mbi-përfaqësuar (Prishtina ka gati pjesë të barabarta të popullatës së gjithëmbarshme dhe të AVL-ve të gjithëmbarshme të kapura. Këto shfira duhen interpretuar me kujdes, pasi që pjesërisht varen nga nivelet e përgjithshme të krimit, përveç që pasqyrojnë nivelet e posedimit të armëve nga civilët.

Figura 4.4 Shpërndarja gjeografike e kapjeve të policisë, mesi i vitit 2000 deri në fund të 2002

Burimi: SIPK

A paraqiten armët më shpesh në disa grupe sociale sesa në të tjerat? Siç u tha më lart, armët përgjithësisht kontrollohen nga pjesëtarët meshkuj të amvisërive. Disa detaje të mëtejme lidhur me grupet e veçanta të armatosura mirë, mund të nxirren nga Anketa në familjare e SABA-së. Respondentët ndaj anketës që besojnë se ka shumë armë në shoqëri u lutën të bëjnë disa pyetje shtesë për të nënvizuar se cilat pjesë të shoqërisë kishin më së shumti armë (shih Shtojcën 1). Nuk është për t'u befasuar që shumica besonin se grupet kriminale ishin tepër mirë të armatosura. Më interesantja është se 15 për qind të shqiptarëve të Kosovës mendonin se biznesmenët kishin shumë armë (por, vetëm një për qind të serbëve mendonin kështu).⁵⁹ Tridhjetë e shtatë për qind të respondentëve serbë të Kosovës dhe 12 për qind të shqiptarëve të Kosovës besonin se kishte shumë armë ndër ish-luftëtarët/ish-paramilitarët. Tetë për qind të shqiptarëve të Kosovës besonin se politikanët kishin shumë armë: udhëheqësit politikë nuk u shfaqën në mesin e përgjegjeve të serbëve të Kosovës.

Fshehja e armëve në shtëpi me kohë është bërë shumë e sofistikuar. Sot, fshehja brenda shtëpisë bëhet kryesisht nëpër vende të ndërtuara veçmas për këtë gjë. Ky sofistikim i shtuar është përgjegje e drejt-përdrejtë ndaj operacioneve të kërkimit të KFOR-it. Gjithnjë e më shumë armë po fshehen nëpër shtëpi, po varrosen në kopshte, ose po fshihen diku më larg. Rrjedhimisht, ka më pak armë në blloqe banimi në qytete sesa nëpër shtëpi private nëpër fshatra.

Në ditët e hershme të kapjeve nga KFOR-i/UNMIK-u, ishte gjë e rëndomtë që të gjinden armë të vogla nëpër kërkime rutinore të automjeteve, që d.m.th. se armët qarkullonin mjaft lirshëm. Sot, duke pasur parasysh gjetjen e ulët në operacionet e kapjes, duket se armët rrallë lëvizin ose se mënyrat e transportimit të tyre janë bërë më të sofistikuar. Tani, më pak se një për qind të kërkimeve rutinore të automjeteve rezultojnë me kapje të armëve.⁶⁰

Kutia 4.2 Armët ne jeten politike te Kosoves

Për dallim nga praktika e përgjithshme gjetiu nëpër Europën perëndimore dhe qendrore, politikanët në Kosovë nuk varen nga ShPK-ja apo Policia e CIVPOL-it për mbrojtje private, por nga truprojat private. Pas investigimit, këto truproja marrin Karta të Autorizimit të Armës (KAA), (shih Seksionin VI)⁶¹, të cilat i autorizojnë që t'i mbrojnë figurat e ndjeshme politike me armë.

Megjithatë, mendohet se, përveç armëve zyrtare të truprojave, partitë politike në Kosovë kanë armatime të tjera. Sipas të intervistuarve që punojnë në çështje sigurie, të gjitha partitë e serbëve etnikë janë 'të pajisura mirë' dhe madje edhe do ta pranonin këtë publikisht në Mitrovicë. Edhe partitë politike shqiptare sigurisht se kanë armë në posedim.

Sipas statistikave të UNMIK-ut për periudhën korrik 2000-dhjetor 2001, 155 incidente të raportuara krimi përfshinin partitë politike, ose si viktime ose si sulmues. Nëntë nga këto kishin të bënin me posedim ilegal armësh, 20 ishin incidente të qitjeve me armë, dhe 14 raste të tjera përfshinin sulme me granata. Rastet e posedimit ilegal të armëve duket se tregojnë që armët nuk po mungojnë nga partitë politike të Kosovës. Për më shumë, fakti se më se 20 për qind të incidenteve të raportuara të krimit përfshinin dhunë të lidhur me armë (qitje me armë dhe sulme me granata)⁶² d.m.th. se jeta politike ka qenë mjaft e dhunshme në Kosovë. Është me rëndësi të thuhet, megjithatë, se dhuna e lidhur me zgjedhjet ka qenë shumë e kufizuar dhe po ulet nga viti në vit.⁶³

Përpjekjet për grumbullimin e armëve pas çmobilizimit zyrtar

Që nga fundi i luftës në qershor 1999, edhe Policia e UNMIK-ut edhe KFOR-i janë përpjekur t'i spastrojnë armët e paligjshme me anë të kërkimeve dhe amnestive.⁶⁴ Ka pasur dy amnesti, nga 1 maji deri më 3 qershor 2001 dhe nga 15 marsi deri më 15 prill 2002. Amnestitë janë organizuar nga KFOR-i dhe UNMIK-u bashkë. Ato u kanë lejuar njerëzve t'ia dorëzojnë armët në mënyrë anonime qoftë policisë qoftë KFOR-it, dhe janë caktuar pika të veçanta dorëzimi për këtë qëllim. Gjatë amnestisë së dytë, më se 80 për qind e armëve janë mbledhur nga KFOR-i, i cili kishte mënyra më të mira organizimi dhe mjete për ta zbatuar amnestinë. Përveç armëve të dorëzuara, autoritetet kanë vënë re se kishte më shumë 'gjetje të rastit' të armëve gjatë periudhës së amnestisë. Kjo si duket tregon se njerëzit që nuk u besonin premtimeve të autoriteteve për anonimitet i lenin armët nëpër zona ku KFOR-i dhe Policia e UNMIK-ut do të mund t'i gjenin lehtë. Kjo po ashtu sugjeron se numri i armëve të mbledhura gjatë amnestive, (listuar në Tabelën 4.3), nënvleftëson rezultatet e përgjithshme të amnestisë.

Tabela 4.3 Rezultatet e amnestisë për armë më 2001 dhe 2002

	Amnestia 2001	Amnestia 2002		
Lloji i armës	GJITHSEJ 2001	KFOR 2002	Policia e UNMIK-ut 2002	GJITHSEJ 2002
Pushkë	400 (afërsisht)	393	24	417
Pistoleta	65	74	1	75
Mitralozë		22	2	24
Mortaja	0	1	0	1
Anti-tank	21	43	2	45
Raketa/ projektilë	16	7	2	9
Granata	200 (afërsisht)*	658	68	726
Mina		51	43	94
Municion	31,000 (afërsisht)	58771	429	59200
Sendë të ndryshme **	75	759	136	895
Gjithsej (pa municion e pa të ndryshme)	777	1,249	142	1391

*Më 2001, granatat dhe minat janë raportuar bashkë në një kategori.

**Sendë të ndryshme' përfshin uniformat, gasmaskat, dhe (më 2001) 75 armë mbështetëse të pakategorizuara.

Burimet: KFOR (2001; 2002b); UNMIK (2001)

Faqe 22

Mangësitë e vërejtura të amnestive përfshinin mungesën e informacionit dhe të komunikimit nga ana e autoriteteve para datës së fillimit, periudhën e shkurtër të tyre, si dhe pikat e grumbullimit tejet të dukshme (që i bëjnë njerëzit të kenë turp nga dorëzimi i armëve). Shikuar nga ky kënd, amnestia e dytë konsiderohet si më e suksesshme sesa e para. Për shembull, në pajtim me amnestinë e vitit 2002, trupat amerikane dhe ruse të KFOR-it kanë punuar bashkë në publikimin e masave, duke shkuar fshat për fshat me megafonë.⁶⁵


Rezultatet e amnestisë kanë qenë më pak të suksesshme ndër komunitetet minoritare të serbëve të Kosovës sesa me komunitetet shqiptare. Një nga arsytet për këtë është pa dyshin fakti se serbët e Kosovës vazhdojnë të ndjehen se duhet ta mbrojnë vetveten. Në Anketën familjare të SABA-së, 27 për qind të respondentëve serbë të Kosovës dhe vetëm 4 për qind të të intervistuarve shqiptarë të Kosovës thanë se mendonin që njerëzit mbanin armë zjarri me qëllim që të siguronin 'siguri politike' (shih Seksionin VI për hollësi).

Përkrahja nga udhëheqësit politikë të Kosovës për amnesti ka qenë e kufizuar. Pranimi ka qenë më i përhapur në nivel gjithëkosovar (ku personalitete politike si presidenti Rugova, kryeministri Rexhepi, udhëheqësi i AAK-së Ramush Haradinaj, si dhe ai i PDK-së Hashim Thaçi kanë shprehur përkrahjen për grumbullimin e armëve gjatë fushatës së vitit 2002) sesa në nivelin komunal. Ka disa përjashtime nga kjo e fundit, megjithatë. Halil Morina, shef ekzekutiv i komunës së Suharekës, tha një ditë para fillimit të amnestisë së dytë, "Nuk na duhen armët, duhet t'i kthehemi punës, përparimit dhe ardhmërisë, për të krijuar një shoqëri të lirë e të sigurt" (cituar në KFOR, 2002, f. 12). Deri më tani, udhëheqësit politikë të serbëve të Kosovës nuk e kanë përkrahur asnjë përpjekje për grumbullimin e armëve.

Mbulimi medial i amnestive tregon se autoritetet ndërkombëtare kanë qenë shtytësja kryesore për promovimin e amnestisë. Nga 109 raporte të shtypit nga qendrat mediale të Kosovës të përfshira në Përmbledhjen Mediale të Amnestisë për Armë (KFOR, 2002a), 38 përmbajnë referenca ndaj autoriteteve vendase, derisa 85 i referohen organeve ndërkombëtare dhe/ose personaliteteve.⁶⁶ Përmbledhja po ashtu tregon se autoritetet vendase, si qeveria dhe TMK, preferonin deklaratat e shkruara kundrejt paraqitjeve personale ose lutjeve personale në shtyp. Ata ishin mjaft pasivë në fazat e para të amnestisë, por u bënë përkrahës më aktivë nga fundi i periudhës së amnestisë.

Amnestitë dhe operacionet e kapjeve ndonjëherë kanë punuar krah për krah. Mbase s'është për t'u habitur se amnestitë kanë sjellë më shumë armë sesa kërkimet nëpër shtëpi e vetura (shih Figurën 4.5). Në disa pjesë të Kosovës, kërkimet janë intensifikuar në muajt para amnestisë së dytë në mënyrë që ta bëjnë popullsinë më të gatshme t'i dorëzojë armët.⁶⁷

Figura 4.5 Krahasimi i rezultateve të operacioneve të kapjeve të KFOR-it dhe amnestive të armëve, 15 mars -15 prill 2002




Shënim: 'sende të ndryshme' përfshin uniformat, gasmaskat, këmbishat antiplumb etj.

*shifrat në mijëra njësi ** shifrat në dhjetëra njësi

Burimi: KFOR

Operacionet e kapjes nga KFOR-i, të njohura jozyrtarisht si Operacioni Shqiponja, vazhdojnë që nga fundi i luftës dhe janë pak a shumë pjesë e përhershme e punës së ushtarëve. Nga janari 2001 deri më 12 mars 2003, trupat e KFOR-it kanë kapur gjithsej gati 3.000 pushkë, 900 pistoleta, 56 mitraloza, 63 mortaja, 450 armë antitank, 74 raketa, 2.200 granata dhe një çerek milioni plumba (shih Figurën 4.6 dhe Tabelën 4.4). Policia e UNMIK-ut, për dallim, kryesisht mbledh armë në përputhje me operacionet për zbatimin e ligjit, sikurse janë kërkimet nëpër shtëpi që janë pjesë e hetimeve të krimin (këto kapje diskutohen sipër).

Figura 4.6 Armët e kapura nga trupat e KFOR-it më 2001 dhe 2002



* shifrat në mijëra njësi **shifrat në dhjetëra njësi

Burimi: KFOR

Faqe 24

Tabela 4.4 Armët e kapura nga KFOR-i, 1 janar-12 mars 2003

Brigada shumëkomb. (BShK)	Pushkë	Pistoletë	Mitralozë	Mortaja	AT	Raketa	Granata	Mina	Municion	Të ndrysh.
BShK qendër	51	11	2	0	0	0	138	3	10610	224
BShK lindje	5	2	2	0	6	4	3	1	852	1
BShK verilin.	43	10	1	0	1	0	35	1	7120	155
BShK jugper.	59	13	5	1	5	5	32	76	5388	616
NJSU	11	12	4	0	0	3	18	0	3895	64
Gjithsej	169	48	14	1	12	12	226	81	27865	1060

Burimi: KFOR

Sipas intervistave me përfaqësues nga bashkësia ndërkombëtare dhe kosovarët, programet e deritashme për kapjet e armëve nuk janë parë negativisht nga popullata e përgjithshme. Natyrisht, ka përjashtime, sikurse bllokimi i rrugës më 2.000 në zonën e Drenicës, ku njerëzit protestonin kundër asaj që e shihnin si kapje të armëve kundër ish-UÇK-së.⁶⁸ Në përgjithësi, megjithatë, dhe përkundër përvojave të vështira në të kaluarën me kapjen e armëve,⁶⁹ përpjekjet e tanishme për të grumbulluar armë ushtarake po priten qetë, meqë popullsia është e vetëdijshme se armët e kapura nuk do të përdoren kundër tyre. Kjo është më pak e vërtetë për kapjet e pushkëve të gjuetisë, të cilat janë ndeshur me rezistencë të ashpër. Armët e grumbulluara momentalisht shkatërrohen brenda Kosovës në fabrikën e shkrirjes së metaleve në Janjevë, në juglindje të Prishtinës. Kjo është po ashtu e vërtetë për ato armë që janë konfiskuar nga policia. Deri më sot një numër prej 18.000 armësh është shkatërruar.

Kutia 4.3 Trashëgimia nga marsi 1997

Një faktor i veçantë i jashtëm që e diktoi shtimin e sasive të armëve në Kosovë ishte rrëmbimi i përnjehertë i më se gjysmë milioni armësh të vogla nga arsenalet shtetërore në Shqipëri. Ka shifra të ndryshme për numrin e armëve të humbura në mars të vitit 1997. Raportet e hershme nga burimet e OKB-së vlerësonin një total prej 643,220 AVL. Shifrat më të shpeshta të policisë shqiptare jepnin numrin prej 549.775 armësh. Dallimi ndërmjet këtyre dy numrave - gati njëqind mijë armë- i cili nuk është analizuar ende, e jo më zgjidhur, është aq i madh në vetvete sa shumë lehtë mund të shkaktojë mynxyra të mëdha.

Një varg projektesh me sponsorë shqiptarë dhe ndërkombëtarë që prej atëherë kanë rigjetur një numër të konsiderueshëm të këtyre armëve nga popullsia e Shqipërisë. Shifrat kapin një numër prej 103,344 armësh sipas burimeve më të detajuara (Tabela 4.5), deri në 200.000 sipas të tjerëve.⁷⁰ Siç tregohet në Tabelën 4.3, megjithatë, sasi të mëdha të rigjetura janë nga ato kategori të armëve më së paku të përshtatshme për luftime guerile, meqë janë pushkë të vjetra dhe pajisje më të rënda si granatahedhës, mortaja, dhe mitralozë madhësish mesatare. Pistoletat dhe pushkët automatike, megjithatë, janë dorëzuar shumë më pak. Hiq këto suksese relative, një sasi e shumë e madhe e armëve mbetet e padorëzuar.

Tabela 4.5 E humbur - e gjetur: Armët e plackitura dhe të rimarrura në Shqipëri, Mars 1997-Shtator 2001

Lloji	të humbura	të rimarrura	% të rimarrura
Pistoletat	38,000	170	0.4
AK-47	226,000	17,522	7.7
Pushkë rrethore	351,000	66,995	19.0
Mitralozë	25,000	11,643	46.0
Granata- hedhës	2,450	792	32.0
Mortaja	770	242	31
Gjithsej	643,220	97,364	15

Note: The Gramsh Pilot Program recovered another 5,980 weapons of unspecified type.

On the Gramsh Pilot Programme see UNDP (2001).

Source: Small Arms Survey (2002, p. 299)

Momentalisht nuk ka se si të përcaktohet përqindja e këtyre armëve që është transferuar nga Shqipëria. Disa pa dyshim janë përvjedhur në tregun e zi ndërkombëtar. Të tjerat kanë rënë në duar të shqiptarëve të Kosovës dhe të Maqedonisë. Edhe pse shifrat nuk dihen, nuk ka se si të jetë rastësi sfidimi që UÇK-ja i bënte autoriteteve të Serbisë në Kosovë u shtua përnjehertë në mars të vitit 1997. Logjika e shëndoshë thotë se afro 150.000 të këtyre armëve kanë arritur tek luftëtarët shqiptarë të Kosovës (dhe, si duket, te civilët) në Kosovë dhe në IRJM, por kjo është vetëm një pandehmë (për shembull, shih Kananin, 2002). Nëse është e saktë, sidoqoftë, shifrat e pandehura të numrit të përgjithshëm të arsenalit të UÇK-së do të duheshin shtuar dukshëm (shih Seksionin IV).

Çmimet e armëve në tregun e zi

Edhe pse nuk janë gjithmonë të lehta për t'u analizuar, çmimet e armëve mund të jenë informata të çmueshme për furnizimin dhe kërkimin e armëve. Në Kosovë në përgjithësi, armët e prodhimit jugosllav janë më të kërkuara sesa ato kineze dhe AK-47-shet që vinë nga Shqipëria. Prodhimet jugosllave janë më cilësore dhe prandaj më të shtrenjta në tregun e zi. Çmimet për një AK-47-she që vjen nga Shqipëria kanë qenë rreth 150-200 EUR në tremujorin e parë të 2003-shit, kurse një AK-47-she jugosllave shkonte te 250-400 EUR (çmim ky që mund të shkojë edhe deri në 550 EUR për të rejtat).⁷¹ Pistoletat 7.62 mm të origjinës shqiptare, gjatë periudhës së njëjtë, kishin çmimin prej 300-350 EUR, derisa ato të origjinës jugosllave shkonin te 400 EUR. Një varg armësh të tjera po ashtu mund të gjenden në tregun e zi.

Çmimet nuk janë të njëtrajtshme nëpër të gjithë Kosovën. Në pjesët lindore dhe qendrore të Kosovës, çmimet janë kryesisht më të larta sesa ato në kufijtë perëndimorë, me një dallim pej 50-100 EUR për të gjitha llojet kryesore të armëve.⁷² Çmimet në tregun e zi në Shqipëri janë edhe më të ulëta sesa në Kosovë, ku pistoletat 9mm shkojnë nga 700-1.000 EUR në Kosovë dhe 400-500 EUR në Shqipëri (pushkët do të shkonin nga 350-600 EUR në Kosovë dhe 200-250 EUR në Shqipëri). Kjo është paralele me dallimin në çmim ndërmjet zonave të kufirit perëndimor të Kosovës dhe pjesës tjetër të saj. Kjo nuk është befasuese kur dihet se shumica e armëve të rrëmbyera më 1997 në Shqipëri ende nuk janë kthyer (shih Kutinë 4.3).

V. Trafikimi i armëve nëpërmjet kufijve të Kosovës

Hyrje

Ballkani, dhe ish-Jugosllavia në veçanti, shpesh shihen si burimi kryesor i tregtimit ilegal të armëve në Europë, sidomos për sasi të vogla të destinuara për grupe të krimit të organizuar. Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia dhe Mali i Zi, dhe Kosova shpesh grupohen bashkë si qendër e problemit (Sagramoso, 2001, f. 48; Paes dhe Matveeva, 2003, f. 50). Megjithatë, kërkimi i bërë për këtë raport sugjeron se trafikimi i armëve nuk është veprimtari aq e madhe në kufijtë e Kosovës, krahasuar edhe me trafikimet e llojeve të tjera si dhe me trafikimin e armëve përgjithësisht në rajon.

Kjo nuk është për shkak se një tregti e tillë do të ishte e pamundshme ose madje e vështirë. Hiq ushtrinë ndërkombëtare dhe praninë e policisë, kufijtë e Kosovës janë porozë. Kjo vlen edhe për kufirin ndërkombëtar me Shqipërinë dhe IRJM-në po edhe me vijat administrative kufitare (VAK) me Serbinë dhe Malin e Zi. Është po ashtu po aq e vërtetë se për kalimin e kufirit ndërkombëtar dhe të pikave kontrolluese të VAK në njërin anë, si dhe të 'kufirit të gjelbër' (kufiri /vija kufitare shtrihet mes kalimit/pikës së kontrollit) në anën tjetër. Kuptohet, krimi i organizuar dhe i paorganizuar përfiton nga ky fakt, dhe prandaj trafikimet dhe kontrabandat janë të lirshme.⁷³

Megjithatë, edhe pse ka sigurisht një tregtim ilegal nërkufitar me AVL, ky është mjaft i vogël -diku me dhjetëra dhe ndonjëherë me qindra armë- kur krahasohet me trafikimin ilegal të qenieve njerëzore, të cigareve dhe të karburantëve.⁷⁴ Meqë Kosova tashmë është e pajisur mirë me armë, kërkesa përqendrohet kryesisht në grupime kriminale dhe ekstremiste politike. Grupe të tilla rëndom i ndërrojnë dhe i përditësojnë pajisjet e veta. Meqë tregu i armëve është relativisht i ngopur, trafikimi me njerëz, cigare dhe karburantë është edhe më pak i rrezikshëm, dhe ç'është më e rëndësishmja, më fitimprurës. Kontrabandimi i kufizuar në sasi më të mëdha i armëve (që përfshin ngarkimet e kamionave) që ekziston, kryesisht mendohet se përbëhet nga bartje (ilegale) nëpër të ashtuquajturin shteg ballkanik.⁷⁵

Faqe 27

Marrëveshjet për kontrollin e kufijve

Edhe pse Marrëveshjet për kontrollin e kufijve nëpër Kosovë janë mjaft komplekse, dhe mbeten krejtësisht nën komandën e UNMIK-ut dhe KFOR-it, ato nuk sigurojnë se kufijtë ruhen plotësisht. Një nga të intervistuarit iu referua kufijve si 'djathë zviceran', dhe disa nga aranzhimet institucionale të kufijve e bëjnë trafikimin më të lehtë.

Në vendkalimet kufitare ndërkombëtare, Policia kufitare e UNMIK-ut është përgjegjëse për kalimin e njerëzve, ndërsa Shërbimi Doganor i UNMIK-ut është përgjegjës për kontrollin e automjeteve. Policia kufitare e UNMIK-ut përfshin edhe oficerë policorë të CIVPOL-it edhe pjesëtarët e ShPK-së lokale. Shërbimi doganor i UNMIK-ut udhëhiqet nga ndërkombëtarët, por njerëzit në terren janë kosovarë.⁷⁶ Sot, aranzhimet janë të njëjta për pikat e kontrollit nëpër vijën kufitare administrative sikurse për kalimet kufitare ndërkombëtare.⁷⁷ Lokacioni i pikave ndërkombëtare kufitare dhe i pikave të VAK-ve varet kryesisht nga topografia: mund të jenë që nga disa qindra metra deri në disa kilometra nga pikat e kontrollit/kalimet ndërkombëtare të Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë apo të Shqipërisë.

Një veçanti e vijës kufitare administrative me Serbinë dhe Malin e Zi është se ajo është e kufizuar me një të ashtuquajtur zonë tokësore sigurie të gjerë 5km, ku roli i policisë dhe i ushtrisë është i kufizuar në funksionin e kontrollimit të vijës kufitare (në formën e pikave të kontrollit). Me fjalë të tjera, kjo është, në shumë mënyra, një rryp toke i pakontrollar dhe shpesh përdoret nga trafikantët dhe ata që kalojnë armë. Të intervistuarit raportojnë

se gjatë natës ka lëvizje të mjaftueshme në shumë pjesë të kësaj toke thuaja të askujt, dhe se kalimi i sasive të vogla të armëve është mjaft i shpeshtë.

Kufiri i gjelbër (qoftë ndërmjet pikëkalimeve ndërkombëtare, qoftë ndërmjet pikave të kontrollit të VAK) kontrollohet nga KFOR-i, në përputhje me ndarjet territoriale të Kosovës në katër sektorë. Vija kufitare veriore me Serbinë kontrollohet nga francezët, rrypi verilindor është përgjegjësi e multinationale, kufiri juglindor si me Serbinë si me IRJM-në, është nën mbikëqyrjen amerikane, ndërsa i gjithë kufiri perëndimor është nën komandën gjermane dhe italiane.

Trafikimi nëpër pika kufitare kontrolli

Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, që funksionon që nga viti 1999, ka një objektiv primar: mbledhjen e të hyrave. Taksat and tatimet e mbledhura nga importet në kufij përbëjnë një përqindje të mirë të të hyrave të mbledhura në Kosovë. Në pajtim me këtë, shërbimi doganor përqendrohet në lëvizjet e ngarkimeve dhe në uljen e kontrabandës (kryesisht të cigareve dhe të karburanteve). Deri më 2002, nuk kishte mandat të 'mbrojtjes së shoqërisë' që të përdorej për t'i ndaluar drogat, farmaceutikët e paautorizuar, armët etj. që hyjnë në Kosovë. Kjo ishte detyrë e policisë doganore, duke marrë parasysh faktin se policia, si rregull e përgjithshme, nuk i kontrollon automjetet, por vetëm njerëzit. Si rrjedhojë, tani për tani nuk ka një përpjekje të përqendruar e efikase për ta ndaluar trafikimin e armëve nëpër pika kufitare, edhe pse kjo do të ndryshojë.⁷⁸ Megjithatë, fakti se autoritetet ndërkombëtare kanë kufizuar kalimin e mallrave nëpër Kosovë i bën përpjekjet me përmasa më të mëdha dhe gjithërajonale të trafikimit më pak joshëse për grupet e krimit të organizuar, të cilat shpesh kanë rrugë të tjera furnizimi.

Faqe 28

Edhe pse nuk ka mandat për 'mbojtjen e shoqërisë', gjatë kontrollit të ngarkimeve, shërbimi doganor ndonjëherë ka bërë kapjen e armëve. Këto kapje janë të dy llojeve kryesore: kapjet më të mëdha të armëve të fshehura në kamiona, si dhe kapjet e vogla të një ose disa armëve të fshehura në vetura.⁷⁹ Kurdoherë që një armë gjendet nga doganat, ajo i dorëzohet policisë kufitare. Policia kufitare vetë po ashtu bën një numër kapjesh. Shprehur krahasimisht, numri i përbashkët i kapjeve nga policia doganore dhe ajo kufitare është shumë i ulët. Siç tregon Figura 4.4, vetëm 37 kapje të AVL-ve, ose 0.8 për qind nga të gjitha kapjet e armëve prej organeve nga mesi i vitit 2000 deri në fund të 2002, janë bërë në kufi. Një tjetër problem është se edhe këto pak kapje nuk janë doemos gjithmonë mirë të investiguara, meqë policia kufitare nuk ka kapacitet të kryejë investigime pas kapjeve.⁸⁰

Këta numra të ulët të kapjeve të armëve duhen interpretuar me kujdes, meqë pasqyrojnë jo vetëm nivelet mjaft modeste të trafikimit të AVL-ve nëpër kufijtë e Kosovës, por edhe faktin se doganat nuk kanë pajisje teknike siç janë makinat me rreze X me të cilat t'i ekzaminonjë ngarkimet që kalojnë kufirin.⁸¹ Për më shumë, doganat kanë pak personel, dhe zyrtarët e doganave, sikurse profesionistët e tjerë në Kosovë, paguhën shumë dobët. Prandaj lehtë mund të pranojnë rryshfet, dhe korrupsioni është një shqetësim i madh. Ky problem njihet nga autoritetet doganore, që kanë themeluar një skemë shpërblimi për t'iu kundërvënë përpjekjeve për dhënie rryshfeti. Sipas kësaj skeme, ekipi doganor që gjen një ngarkim të armëve ilegale shpërblehet me shumën që varet nga sasia e kapjeve, por që mund të jetë disa herë më e madhe sesa një pagë mujore. Hiq këto masa, armët e fshehura nëpër vetura dhe kamiona sigurisht se mund t'i kalojnë kufijtë e Kosovës kurdoherë.

Doganat nuk janë të thirrura t'i kontrollojnë të gjitha ngarkimet: ato të organizatave humanitare dhe kontraktuesit e KFOR-it janë të liruara nga doganat. Ka pasur raste kur thuhet se pjesëtarët e kontigjenteve më pak të paguara kanë shoqëruar vetura civile plot me cigare dhe para deri në kufi për t'iu shmangur kontrollit doganor. Asnjë ushtar, megjithatë, nuk është kapur duke futur armë.⁸³

Harta e Kosovës (rrugët e trafikimit)



Façe 29

Rrugët e trafikimit, kufiri i gjelbër, dhe tregtimi i brendshëm

Futja e AVL-ve përmes kufirit të gjelbër është e shpeshtë por jo veçanërisht e madhe. Trafikanët nëpër kufirin e gjelbër përdorin të njëjtat metoda që janë përdorë gjatë luftës. Futja e armëve shpesh bëhet me gomarë ose mushka, që ose udhëhiqen nga një njeri, ose, më shpesh e kalojnë kufirin të pashoqëruar. Një mushkë normalisht bart 20-30 pushkë me secilin kalim. Tregtia me mushkë është e shpeshtë në zonat malore të Kosovës.

Me ta kaluar mushka kufirin, ngarkimet e saj kalohen në mjete më moderne transporti, sidomos kamiona ose furgona të përgatitur, në të cilët ata transportohen në të gjithë Kosovën. Si rezultat i operacioneve kundër futjes së armëve, KFOR-i ndonjëherë ka konfiskuar deri në 30-40 mushka për futje armësh, situatë kjo që nuk ka qenë pa vështirësi praktike.⁸⁴

Në Kosovë, armët futen kryesisht nga perëndimi dhe veriu, dhe dalin drejt jugut dhe lindjes. Armët hyjnë nga Serbia dhe Mali i Zi (nga ku vinë kryesisht, edhe pse jo vetëm armë të kërkuara të cilësisë së lartë të prodhimit jugosllav) dhe nga Shqipëria, e cila është burimi kryesor i armëve më të lira të prodhimit kinez. Armët nga Serbia dhe sidomos ato nga Mali i Zi shpesh vinë nga pak më larg: Bosnja e Hercegovina është një burim i shpeshtë që nga koha e luftës (shumë boshnjakë bashkëndjenin me UÇK-në, dhe Bosnja e Hercegovina ka një industri të rëndësishme të AVL-ve).⁸⁵ Armët dalin nga Kosova kryesisht për në IRJM, ku kërkohen nga elemente kriminale dhe separatiste të atjeshme, por po ashtu për në Serbinë jugore dhe më tej. Hiq ndalimin e këtyre futje-daljeve, ka mjaft transit të paligjshëm armësh nëpër Kosovë.

Shtigjet kryesore janë të njëjtat me ato për trafikimin e mallrave të tjera. Në përgjithësi, armët transportohen nëpër rrugët kryesore. Një pikë e madhe tubimi është Peja. Një tjetër rrugë transit është përmes pikës më jugore të Kosovës, nga Shqipëria nëpër (Dragash) për në Tetovë.

Trafikimi me armë, sikurse me mallra të tjera (dhe me njerëz), është një veprimtari e organizuar. Megjithatë, nuk është e qartë nëse, ose në ç'masë, trafikimi i armëve është i lidhur me format e tjera të trafikimit. Shumica, edhe pse jo të gjithë të intervistuarit që punojnë në sektorin e sigurimit theksuan se trafikimi është i organizuar gjeografikisht: një familje/fis kontrollon një zonë të Kosovës, përfshirë të gjitha format e trafikimit nga dhe jashtë atij rajoni. Kjo nënkupton se rrjetet e trafikimit të paligjshëm janë të lidhura, të paktën brenda Kosovës.

Vendet ku armët mund të blihen brenda Kosovës janë kafeteritë dhe tregjet nëpër Kosovë. Kontaktet personale dhe ndonjëherë familjare janë të rëndësishme për të rënë në kontakt me shitësit.⁸⁷ Por, edhe pa kontakte të tilla, nuk është e vështirë që të gjendet një armë. Është e mundur të bëhen porosi me disa tregtarë të caktuar për një model të caktuar arme, duke përfshirë prodhimet perëndimore, që mandej blihen jashtë dhe çohen nëpër kufijtë e Kosovës posaçërisht për klientin në fjalë.

Supozohet gjithandëj se ushtarët e disa kontigjenteve të stacionuara në Kosovë, që paguhën dobët, janë të përfshirë në veprimtari të ndryshme trafikimi, sidomos në atë me karburantë. Megjithatë, trafikimi i armëve, pikërisht për shkak të përfitimit kryesisht të ulët, nuk mendohet të jetë në mesin e tyre.⁸⁸ Për dallim, besohet se ushtarët e KFOR-it gjerman janë përfshirë në një incident të trafikimit të armëve që është bërë tejet publik. Armët e vogla të grumbulluara në Prizren janë dërguar në IRJM dhe pastaj në Darmstadt të Gjermanisë (Davis, 2002, f. 57).

VI. Kultura e armëve dhe rregulloret e armëve, dikur dhe sot

Kultura e armëve ndër shqiptarët e Kosovës: 'Votra pa armë nuk është shtëpi'

Si edhe në shumë vende të tjera të botës, armët janë bërë pjesë e relievit kulturor shqiptar. Në mesin e personelit i cili shërben në Kosovë, referencat ndaj kulturës së armës te shqiptarët dhe, në mënyrë të veçantë, ndaj Kanuni janë të zakonshme kur shpjegohet (keq)përdorimi i armëve te shqiptarët në Kosovë dhe lidhja e tyre me armët. Kanuni është ligji i zakoneve i cili, në mungesë të një qeverie efikase, e ka rregulluar jetën sociale në Shqipërinë Veriore dhe në Kosovë për shumë shekuj. Disa nga ligjet, siç pohohet, datojnë që nga Ilirët, të cilët shqiptarët i konsiderojnë paraardhës të tyre. Kodi i shkruar ka qenë vënë në letër në shekullin pesëmbëdhjetë nga Lekë Dugagjini: që këndej rrjedh emri - *Kanuni i Lekë Dugagjinit*.

Kanuni përmban një numër të madh referencash për armët dhe përfaqëson një kod socio-ligjor i cili rregullon përdorimin e armëve të zjarrit. Arma, në mënyrë të njohur, paraqitet si një formë e mbrojtjes dhe si mjet i rregullimit të drejtësisë. Nëse një person e vret priftin, për shembull, është specifikuar në Kanun se ai do të ekzekutohet nga "skuadra pushkatuese" (para. 17).⁸⁹ Një pjesë e madhe e legjislacionit e cila ka të bëjë me vrasjen, cakton se kur vrasja është bërë - edhe hakmarrja duhet bërë - me armë. Krimet e tjera, siç është pabesia, po ashtu, trajtohen me anë të armës. Sipas Kanunit, nëse burri e zë gruan e tij me një mashkull tjetër, ai mund t'i vrasë që të dy. Nëse ai e përdor një plumb të vetëm, nuk rezulton ndonjë mosmarrëveshje gjaku (para. 923). Sipas fjalëve të Kanunit, "Prindërit e çiftit të pabesë nuk duhet të kërkojnë hakmarrje, por duhet t'i japin vrasësit një karikator të ri me fjalët: "Qoftë e bekuar dora jote". (para. 924). Megjithëkëtë, armët, tradicionalisht, nuk janë menduar të shfaqen në shoqëri. Armët, sipas traditës shqiptare, nuk duhet të jenë të dukshme dhe bartësi i armës nuk duhet të jetë krenar me to. Nëse bartësi i armës ka shpërfillur këto rregulla, sanksionet ishin të ashpra (Hasani, 2003).

Faqe 31

Sidoqoftë, roli i kodeve dhe i rregullave të tilla sociale në rregullimin e jetës bashkëkohore shpesh është tejtheksuar dhe përmasa në të cilën kodet e tilla antike ndikojnë mbi sjelljen është e diskutueshme. Rregullat e Kanunit, për shembull, lidhur me kufizimet në përdorimin e forcës dhe të shfaqjes së armëve është zbehur dalngadalë. Respektimi i ndalesave të Kanunit (në të gjitha fushat e jetës) po ashtu është dobësuar me migrimin nga zonat rurale në ato urbane dhe duket të ketë humbur shumë nga fuqia e tij në Kosovë derisa sundimi i ligjit është forcuar. Qëndrimi ndaj armëve dhe kultura e armëve duket të jenë zvogëlar përgjatë ndarjeve të gjeneratave, po ashtu, veçanërisht me banorët e rinj urbanë që potencialisht janë të një mentaliteti kundër armës e të cilët i perceptojnë armët si diçka të kaluarës ose si "punë fshatarësh". Përvojat e refugjatëve i kanë kthyer disa të rinj kundër armëve.

Statusi i përgjithshëm i cili rrjedh nga armët, veçanërisht nga armët ushtarake, nuk është zvogëluar substancialisht, por kjo mund t'i atribuohet famës së UÇK-së dhe rolit të armëve në aktivitetet kriminale. Në përgjithësi, trysnitë e modernizimit, duke përfshirë këtu edhe dekadat nën sundimin komunist, kanë bërë që Kanuni, së paku sa ka të bëjë me armët, ofrojnë më shumë një kontekst më të larmishëm dhe një arsytim për sjelljen sociale sesa një model të rreptë të rregullave që aktualisht sundojnë mbi jetën sociale në Kosovë sot.⁹⁰

Kutia 6.1 Historia e grumbullimit të armëve në Kosovë

Programet e mbledhjes së organizuar të armëve kanë një histori të gjatë dhe të rëndë në Kosovë.

Konfiskimi i armëve daton së paku që nga koha e Perandorisë Turke. Më 1884, si pjesë e një pakoje të një reforme të modernizimit, autoritetet në Stamboll kishin filluar të forcojnë kontrollin e tyre mbi rajonet e tyre të qeverisura më të largëta, siç është Kosova. Në këto masa të reja, po ashtu, përfshihen edhe përpjekjet për të çarmatosur popullatën vendase. Ngaqë reforma e modernizimit ishte rezistuar fuqishëm në Kosovën konservative përgjatë dekadave pasuese, shumë armë qenë konfiskuar në fushatat e mëvonshme me qëllim të mbajtjes së popullatës nën kontroll. Një nga arsytet pse të ashtuquajturit Turqit e Rinj revolucionarë kishin pasur mbështetjen e shqiptarëve konservatorë në Kosovë në përpjekjet e tyre për ta luftuar pushtetin nga mbikëqyrësi i vjetër i Stambollit, ka qenë se ata kishin premtuar t'i respektonin të drejtat tradicionale të shqiptarëve, duke përfshirë edhe të drejtën e bartjes së armëve.

Në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit njëzet, populli në Kosovë prapë rebelohet kundër otomanëve, këtë herë për shkak të taksave të reja. Për të shtypur qëndresën, trupat otomane qenë dërguar në Pejë dhe Gjakovë, ku taksat qenë mbledhur me dhunë, popullata regjistrohej dhe armët konfiskoheshin. Për shembull, siç pohohet, më 1910, 147.525 armë qenë mbledhur me mjete të egra. Në të njëjtën lëvizje, të gjitha thikat, pos atyre të bukës, qenë ndaluar.

Gjatë gjysmës së parë të shekullit njëzet, kur shqiptarët ishin nën sundimin Serb/Jugosllav, xhandarmëria serbe kishte zhvilluar ato që quhen ekspedita të armëve, po të cilat, në të vërtetë, ishin bars me dhunën sistematike mbi baza etnike kundër shqiptarëve. Në periudhën e hershme pas Luftës së Dytë Botërore, policia federale jugosllave, nën Ministrin e Punëve të Brendshme, Aleksandër Rankoviqin, përpiqej të mblidhte armët me dhunë nga popullata. Në dimrin e vitit 1956, këto programe të konfiskimit shtëpi për shtëpi kishin shpënë deri te rrahjet, torturat dhe, madje, edhe vrasjet. Sipas Noel Malcolmit, "aq i egër ishte trajtimi i atyre të cilët nuk dorëzonin armën, saqë shumë shqiptarë, me shumë kujdes, do ta blenin atë me qëllim që të kenë diçka për të dorëzuar". (1998, f.320 - 321).

Meqë federata jugosllave u shpërbë në vitet '90-të, Millosheviqi vazhdoi traditën e mbledhjes me dhunë të armëve. Shqiptarët në Kosovë qenë rrahur, torturuar ose gjobitur gabimisht në operacionet e konfiskimit të armëve.

Burimet: Malcolm (1998); Jansen (2002)

Qëndrimet ndaj armëve në Kosovën e sotme

Ndërsa është e vështirë që saktësisht të përshkruhen perceptimet e kosovarëve për armët e vogla, zbulimet nga hulumtimi i SABA-së sugjerojnë se kosovarët nuk janë aq të lidhur për armët aq sa besohet zakonisht. Të pyetur nëse ka së tepërmi armë në shoqëri, 47 për qind e të anketuarve të hulumtimit janë përgjegjur "po" dhe vetëm 21 për qind ka thënë "jo" (për përqindjen e mbetur të cilët janë përgjegjur "nuk e di": shih Shtojcën 1). Ngjashëm, mbi 50 për qind e të anketuarve mendonte ose kaq gjasa ose ka disa gjasa që

njerëzit në rrethinën e tyre t'i dorëzonin armët në këmbim për investime në bashkësinë e tyre. (Shtojca 1). Së fundi, 54 për qind e të anketuave kanë pohuar se ata nuk do të përcaktoheshin për të mbajtur armën madje edhe po të ishte legale (Shtojca 1). Këto rezultate sugjerojnë se modeli i posedimit të armëve në mesin e Kosovarëve nuk është aq joelastik ose kulturalisht i kushtëzuar siç është besuar përpara.

Sidoqoftë, ashtu siç është treguar në pjesët e përparme, Kosova mbetet një shoqëri e armatosur rëndë. Rezultatet e hulumtimit sugjerojnë se ekzistojnë dy motive qendrore që e shpjegojnë posedimin e armëve në Kosovë: siguria personale dhe mbrojtja, si dhe aktiviteti si gjuetia (shih Shtojcën 1 lidhur me hollësitë). Ndërsa bashkësitë e të dyja grupeve etnike, shqiptarë dhe serbë, duket se pajtohen që gjuetia është një arsye e ligjshme për mbajtjen e armëve, ekzistojnë disa dallime të ndjeshme lidhur me perceptimet e këtyre dy grupeve sa i përket sigurisë dhe mbrojtjes. Shqiptarët në Kosovë janë të prirur ta shohin krimin si kërcënimin kryesor për shoqërinë e tyre: 70 për qind e tyre mendojnë se ekzistojnë tepër shumë armë në duart e grupeve kriminale. Ata, po ashtu, ndjejnë se situata e sigurisë në Kosovë është duke u përmirësuar dhe kanë besim të madh në institucionet e tashme të sigurisë, posaçërisht në Shërbimin Policor të Kosovës. Shqiptarët ndjehen relativisht rehat me institucionet e tashme shtetërore dhe pasiguria e tyre më shumë lidhet me krimin sesa me institucionet.

Derisa serbët e Kosovës po ashtu e aryetojnë posedimin e armëve në kuptimin e sigurimit të sigurisë personale dhe familjare, ata duken më shumë të brengosur lidhur me faktorët politikë sesa homologët e tyre shqiptarë në Kosovë. 31 për qind e serbëve të Kosovës ka thënë se ata do të përcaktoheshin të kenë një armë zjarri për arsye "politike", derisa vetëm 4 për qind e shqiptarëve në Kosovë të pyetur u përgjegjën kështu. Megjithëse mbesin të ndjeshëm ndaj numrit të armëve në duart e kriminelëve, serbët janë shumë më shumë të brengosur sesa shqiptarët në Kosovë nga armët në duart e ish-luftëtarëve dhe të shoqërisë si tërësi. Kjo pasqyron pakënaqësinë e tyre me situatën e tashme politike dhe mosbesimin në ofruesit e tashëm të sigurisë: serbët do të parapëlqenin të kishin autoritetet serbe dhe milicinë e tyre për të rregulluar sigurinë e tyre dhe nuk besojnë se situata e sigurisë po përmirësohet. Në fund, serbët janë shumë më pak entuziastë sesa shqiptarët lidhur me gjasat që njerëzit t'i dorëzojnë armët në këmbim të investimeve në bashkësi.

Këto rezultate sugjerojnë se perceptimi i kosovarëve lidhur me armët në masë të madhe varet nga niveli i tyre i kënaqësisë me situatën e tashme politike. Shqiptarët në Kosovë janë të kënaqur me situatën e tashme politike dhe atë të sigurisë dhe, së këndejmi, e shohin traditën dhe mbrojtjen nga kriminaliteti si motiv kryesor pas të cilit qëndron posedimi i armëve. Serbët etnikë, në anën tjetër, shumë më pak janë në pajtim me masat e tashme të institucioneve dhe i japin pasigurisë politike më shumë peshë në kuptimin e arsyetimit të posedimit të armës.

Kutia 6.2 Zjarri festiv

Zjarri festiv është fare i zakonshëm në Kosovë dhe element normal në festime, siç është martesat dhe festa e Vitit të Ri. Kundër kësaj, normalisht kurrfarë aksionesh policore nuk ndërmerren, megjithëse kjo pak a shumë varet nga kombësia e oficerit përgjegjës të policisë së UNMIK-ut. Në përgjithësi, autoritetet ndërkombëtare do të ndërhyjnë vetëm nëse pjesëtarët e ShPK-së ose të TMK-së janë të përfshirë në qitje. Pjesëtarët e tillë të forcave të sigurisë normalisht se ndeshen me masa disiplinuese.

Nuk ekzistojnë statistika mbi lëndimet nga zjarri festiv në Kosovë. Megjithëkëtë, serioziteti i lëndimeve të tilla nuk duhet të nënvleftësohet.

Ligjet mbi armët në Kosovë

UNMIK-u tash është duke u përpjekur të krijojë një kornizë të legjislacionit të posedimit dhe të transferit të armëve të vogla në Kosovë. Deri më tash, rirregullimi është vetëm i pjesshëm. Së këndejmi, në disa sektorë, siç është ai i importit dhe i eksportit, si dhe prodhimi i AVL-ve, nuk ekzistojnë rregullore ose ligje postjugosllave.

Posedimi civil është rirregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/7 mbi Autorizimn e Mbajtjes së Armëve në Kosovë. Sipas këtij Ligji, personat që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë mund të marrin lejen për të mbajtur të ashquajturat Kartën e Autorizimit të Armës (KAA) e cila u lejon atyre të sigurojnë dhe të mbajnë armën gjatë gjithë kohës.⁹¹ Vetëm "personat e rrezikuar", pra, personat të cilët, sipas raporteve të policisë dhe vlerësimit të sigurisë, ballafaqohen me rreziqe të rënda, mund të marrin KAA-në. I ashtuquajturi Komisioni i Vlerësimit të Rrezikut, i krijuar nga komisioneri i Policisë së UNMIK-ut, vlerëson secilin aplikant të KAA-së. KAA-ja mund t'i jepet vetë personit të rrezikuar ose, më shpesh, rojes së tij ose të saj të regjistruar.

Policia e UNMIK-ut ka lëshuar karta të tilla në mënyrë shumë të kufizuar. Mesatarisht, më pak se dhjetë për qind e aplikantëve janë pranuar, kryesisht individë të cilët ballafaqohen me rreziqe të veçanta, duke përfshirë këtu edhe figurat udhëheqëse të partive kryesore politike. Arma më e rëndë e autorizuar është AK-47.

Llojet e tjera të armëve, duke përfshirë armët e gjuetisë dhe të rekreacionit, janë të paligjshme sipas Rregullores 2001/7. Dënimi për armëmbajtje të paligjshme është shumë i rëndë: maksimumi prej tetë vitesh ose gjoba deri në 7,500 EUR ose të dyja.⁹² Në praktikë, sidoqoftë, ndjekja e këtij lloji të krimit ka qenë relativisht e rrallë.

Armët e gjuetisë dhe të rekreacionit kohët e fundit po ashtu janë rirregulluar. Gjuetarët dhe qitësit rekreativë munden, mes 1 Shkurtit dhe 1 Majit të vitit 2003, të regjistrojnë armët e tyre të gjuetisë dhe të rekreacionit⁹³ në stacionet e tyre lokale të policisë pa u ndeshur me ndjekjen. Poseduesit mund të regjistrojnë aq armë të llojeve të lejuara sa ata dëshirojnë. Pasi që periudha e faljes ka përfunduar më 1 Maj, poseduesit e armëve të gjuetisë dhe të rekreacionit ende mund t'i regjistrojnë armët e tyre. Megjithëkëtë, nëse konstatohen të paregjistruara, armët do të konfiskohen nga Policia e UNMIK-ut dhe e KFOR-it dhe poseduesit e tyre mund të ballafaqohen me ndjekje penale. Pas regjistrimit, aplikantët marrin Lejen e Regjistrimit të Armës e cila është e vlefshme për dy vjet. Prej 1 Majit të vitit 2003, më shumë se 20.000 armë janë regjistruar.⁹⁴ Numri i gjuetarëve të organizuar është pak më i vogël sesa 9.000.⁹⁵

VII. Efektet e drejtpëdrejta dhe të tërthorta të armëve në Kosovë

Hyrje

Të qenët në dispozicion në masë të madhe i armëve ka pasur një numër pasojash për shoqërinë kosovare, madje edhe gjatë viteve që nga përfundimi i luftës. Pasojat e drejtpëdrejta përfshijnë lëndimet fatale dhe jofatale si dhe invaliditetin psikologjik dhe fizik për shkak të keqpërdorimit të armëve të vogla. Në këtë pjesë janë diskutuar vetëm lëndimet fatale dhe jofatale, ngaqë nuk ka të dhëna në dispozicion për invaliditetin psikologjik ose fizik. Pasojat e tërthorta janë më të shumta - duke përfshirë dimensionet sociale, ekonomike dhe zhvillimin njerëzor - dhe, nganjëherë, janë më të vështira për t'u kuantifikuar. Në këtë pjesë, dy pasoja të tërthorta të përdorimit të armëve janë hulumtuar në më shumë hollësi. Ekzistojnë armët në ambientin e krimit dhe në ambientin e shkollës. Nga pasqyra e shkurtër në këtë pjesë, duket qartë se armët kanë pasur një ndikim të ndryshëm në shoqëri duke ndikuar, për shembull, në krimin më shumë sesa në ofrimin e ndihmës njerëzore.

Lëndimet fatale dhe jofatale

Në vitin 2002, lëndimet nga armët e zjarrit kanë rezultuar në 98 vizita spitalore anekënd Kosovës, krahasuar me 15 vizita në vitin 2001 (lidhur me hollësitë, shih Figurën 7.1)⁹⁶ Shifrat janë dukshëm më të vogla sesa ato fill pas luftës: në periudhën gjashtëmujore nga qershori deri në dhjetor të vitit 1999, 100 lëndime me armë zjarri janë raportuar nga Spitali Universitar i Prishtinës, i cili është spitali kryesor referues për lëndimet traumatike në Kosovë.


Faqe 35

Shifrat e mësipërme me gjasë nuk janë më të ulëta sesa numri aktual i lëndimeve me armë zjarri. Zona e përfshirjes e Spitalit Universitar të Prishtinës është gjithëkosovare. Sidoqoftë, disa klinika të tjera të mëdha gjetu në territorin e Kosovës po ashtu i trajtojnë lëndimet. Serbët më së shpeshti parapëlqejnë të mjekohen nga lëndimet e tyre në Mitrovicë (ose, nëse jetojnë në enklava në jug-lindje, në kampin e Bonsteel-it, në Shtabin e Brigadës Shumëkombëshe të Shteteve të Bashkuara). Kjo është pasqyruar në statistikat e mësipërme, ngaqë nuk ka raste të raportuara me pacientë nga Zubin Potoku, Zveçani ose Novobërda (shih Tabelën 7.1 në Shtojcën 5).

Numri përgjithshëm i lëndimeve, së këndejmi, është me gjasën më të madhe më i lartë sesa që pasqyrohet në statistikat e Spitalit Universitar të Prishtinës. Po ashtu është konstatuar se jo të gjitha lëndimet për shkak të dhunës i nënshtrohen kujdesit mjekësor, posaçërisht jo nëse lëndimet janë rezultat i problemeve të kriminalitetit. Kjo, po ashtu, ndikon në uljen e shifrave të lëndimeve. Shifrat, megjithëkëtë, flasin për një trend të rënies së lëndimeve me armë zjarri.

Fatkeqësisht, nuk është e mundur të kontrollohen këto shifra me shifrat e paraluftës. Lidhur me të dhënat e tjera statistikore (si ato të lidhura me krimin), të dhënat për lëndimet ose çoheshin në Beograd nga serbët etnikë që arratiseshin nga Kosova ose janë shkatërruar gjatë luftës.

Lëndimet me thikë dhe rrahjet është e vështirë të interpretohen krahasuar me lëndimet me armë zjarri, kryesisht për shkak se shumë lëndime të tilla trajtohen në nivel lokal, veçanërisht në vitin 1999. Megjithëkëtë, duket se ekziston një trend drejt një proporcioni më të madh të lëndimeve që nuk lidhen me armët në Kosovë. Për krahasim, duhet të vërehet se lëndimet e shkaktuara nga dhuna e qëllimshme janë të zvogëluara nga një burim tjetër i lëndimeve: nga aksidentet e trafikut. Në periudhën qershor - dhjetor të vitit 1999, lëndimet e trafikut kanë rezultuar me një numër të përgjithshëm të 1.361 vizitave spitalore. Në vitin 2001, shifra ka qenë 1.230; në vitin 2002 ishte 1.883.⁹⁷

Figura 7.1 Raporti spitalor mbi arsyet e vizitave/lëndimeve

Burimi: Spitali Universitar i Prishtinës

Armët në krim

Siç u diskutua më në hollësi në Seksionin III, krimi i dhunshëm nuk është aq i lartë në Kosovë.⁹⁸ Vrasjet, plaçkitjet, dhe nivelet e sulmeve të raportuara janë të ngjashme ose më të ulëta sesa ato në vendet e tjera të rajonit. Si rrjedhojë, populli i Kosovës po ashtu po ndjehet përherë e më i sigurt.


Megjithatë, në krimet që kryhen në Kosovë mbizotërojnë armët. Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës, një bankë të dhënash e themeluar nga Policia e UNMIK-ut që mbulon të gjitha krimet e bëra në Kosovë, jep informata detaje mbi sasinë e përdorimit të armëve në krim. Nga 76 vrasje të raportuara më 2002, 55 (ose 72 për qind) janë kryer me armë zjarri. Për dallim, vetëm shtatë nga 55 rastet e rrëmbimit (13 për qind) të njëjtin vit përfshinin armë zjarri (shih Tabelën 7.2 poshtë). Plaçkitjet dhe sulmet e provokuara vinë në mes, me rreth 31 për qind dhe 22 për qind respektivisht, të kryera me armë zjarri.

Kosova ka shkallë të lartë të krimeve me armë kur krahasohet me vendet e tjera. Për krahasim, Tabela 7.2 paraqet sasinë e vrasjeve dhe të plaçkitjeve të kryera me armë zjarri në tri vende të tjera të zgjedhura. Në Estoni dhe Hungari, dy shtete të tjera paskomuniste, nivelet e vrasjeve me armë zjarri ishin 13 për qind dhe 11 për qind respektivisht. Përqindja e lartë e vrasjeve të kryera me armë zjarri në Kosovë e bën më pak të mundshme që armët e zjarrit të zënë vendin e llojeve të tjera të armëve/mjeteve për kryerjen e vrasjeve (që në kriminologji quhet edhe efekti i zëvendësimit). Edhe pse kjo është paksa spekulative, duket se një gjendshmëri e gjerë e armëve në vetvete mund ta ketë shtuar numrin e vrasjeve në Kosovë. Detajet e rasteve të vrasjeve duket se e konfirmojnë këtë, meqë disa kanë një komponentë aksidenti brenda vetes, ose janë rezultat i një qasjeje të të dyshuarit ndaj një arme gjatë përndezjes së zënkës. (shënimet e Policisë së UNMIK-ut, çështje të ndryshme).

Edhe në rastin e plaçkitjeve, Kosova është paksa jonormale krahasuar me Estoninë dhe Hungarinë. Plaçkitjet kanë dy herë më shumë gjasa të kryhen me armë zjarri në Kosovë sesa në Estoni, dhe katër

herë më shumë gjasë sesa në Hungari. Fakti se armët përdoren më pak në rrëmbime duket të jetë i ndërlidhur me faktin se një numër i madh rrëmbimesh në Kosovë lidhen me konflikte ndërfamiljare ose hasmëri ndërfamiljare. Kjo, më tej, me sa duket flet se armët, ndonëse mund të gjenden gjithkund, nuk përdoren në mënyrë paushalle.

Figura 7.2 Përqindjet e krimeve të raportuara të kryera me AVL, kategori të përzgjedhura



Shënim: shifrat e Kosovës për plaçkitjen dhe sulmet e provokuara janë bazuar në një mostër paushalle që përbëhet prej 50 për qind të numrit total të rasteve. Shifrat e Estonisë dhe të Hungarisë janë një mesatare e viteve 1997-2001.


Burimet: SIPK; Ministria e Brendshme, Estoni; Ministria e Brendshme, Hungari

Faqe 37

Të dhënat mbi tipet e armëve të zjarrit të përdorura në aktet e dhunës janë shumë më shumë ilustrative, meqë modeli ose tipi është shënuar rrallëherë.⁹⁹ Nga sa është indikuar, mund të konkludohet se AK-të dhe pistoletat mbizotërojnë si tipe të njohura armësh të përdorura në vrasje, rrëmbime, plaçkitje, dhe sulme të provokuara.


Kjo po ashtu vërtetohet nga diskutimet me grupet e synuara që janë bërë për këtë studim. Në të gjitha diskutimet, pistoletat dhe armët automatike (bashkë me thikat) janë renditur si tri armët më të rrezikshme (Index Kosova/Gallup International 2003b). Meqë pistoletat dhe armët automatike, bashkë me pushkët e gjahut, janë më të shpeshtat armë ndër popullatën civile në Kosovë, kjo gjë nuk është aq befasuese. Por, kjo ka implikime për grumbullimin e armëve dhe përpjekjet e kontrollit. Çdo përpjekje për të grumbulluar armë mund të përqendrohet në ato armë që më së shpeshti shoqërojnë dhunën. Prandaj, duket se AK-47-sheve dhe pistoletave, më parë sesa pushkëve të gjahut ose armëve të tjera, duhet t'u kushtohet më shumë vëmëndje në raportin AKZh pilot të vitit 2003 të UNDP/ISAC.

Figura 7.3 Tipet e AVL-ve të përdorura në vrasje, 2002




Burimi: SIPK

Figura 7.4 Tipet e AVL-ve të përdorura në rrëmbime, 2002




Burimi: SIPK

Figura 7.5 Tipet e AVL-ve të përdorura në plaçkitje, 2002



Burimi: SIPK

Figura 7.6 Tipet e AVL-ve të përdorura në sulmet e provokuara, 2002



Burimi: SIPK

Mjedise pa armë? Armët dhe shkollat

Sipas anketës së bërë nga International Rescue Committee dhe UNDP, prania e armëve në shoqëri ishte një nga dhjetë shqetësimet kryesore të rinisë kosovare më 2001, dhe ndër pesë shqetësimet më të mëdha të shqiptarëve të Kosovës (IRC dhe UNDP, 2001, f. 6, f. 55-56). Para një viti, UNDP-ja ka mbajtur një varg të diskutimeve të tipit të punëtorive me grupe rinore në Kosovë për t'i nxjerrë perceptimet e tyre mbi shkallën e problemit të armëve të vogla. Gjatë këtyre diskutimeve, rinia vazhdimisht theksonte se rreth 25-50 për qind të tyre mund ta siguronin personalisht dhe mjaft lehtë një armë zjarri brenda 24 orësh (UNDP, 2000). Të rinjtë që merrnin pjesë në diskutime besonin se ndërmjet 5 dhe 20 për qind të të gjithë nxënësve ishin të armatosur ose pohonin se ishin të armatosur në shkolla. Ky numër nuk ishte i njëjti në të gjitha shkollat: ishte më i ulët në shumë shkolla të mesme të specializuara (medicina, ekonomiku, etj.) sesa nëpër gjimnazet më të mëdha. Në të njëjtën kohë, diskutimet shpalosën se rinia nuk ndjehej e sigurt në shkolla. Kushtet e sigurisë në shkolla ishin të dobëta. Më problematikja ishte rinia nga jashtë shkollës që vinte në oborrin e shkollës për t'i kërcënuar ata brenda saj. Vajzat e reja shpesh janë sulmuar.

Nga fillimi i vitit 2003, situata ndryshoi në disa mënyra, por në disa të tjera mbeti e njëjta. Për këtë raport hulumtimi, Iniciativa Kosovare për Shoqëri Demokratike (KIDS) ishte komisionuar nga UNDP dhe UNICEF-i që të ndërmarrë kërkime nëpër shkollat e Kosovës, (nëpër institucionet urbane/rurale dhe të shumicës ose të pakicave), në mënyrë që ta investigojë çështjen e dhunës dhe të përdorimit të armëve. Personeli nga 15 shkolla, 8 shkolla fillore dhe 7 shkolla të mesme, është intervistuar nga një ish-mësues lidhur me dhunën në përgjithësi dhe përdorimin e armëve në veçanti.¹⁰⁰ Ky studim tregon se situata në disa pikëpamje ka evoluar paksa që nga viti 2000. Kjo i lë të hapura disa çështje të tjera, që duhen qartësuar përmes studimeve të mëtejme, kryesisht si pasojë e mësuesve që kanë pikëpamje të ndryshme për situatën e sigurisë në shkolla nga studentët dhe nxënësit.

Në intervista, mësimmësuesit theksuan se rrahjet fizike, edhe në shkollat fillore edhe në ato të mesme, janë kryesisht rrahje me grushta, pa përfshirjen e armëve dhe as të kurrfarë mjeteve të tjera. Në ato pak raste kur një armë është implikuar në rrahje, ajo është kryesisht thikë, zinxhir, ose boks i hekurt. Incidentet me armë zjarri janë shumë të rralla: në të 15 shkollat, 2 incidente janë regjistruar (në njërin

incident, është vënë re pistoleta në xhepin e nxënësit, në një tjetër nxënësi ka qitur mbi shokun e klasës me një pistoletë punim-dore jofunksionale).

Megjithatë, administratorët dhe mësime të mesme kanë kërkuar praninë e policëve në mënyrë që ta shmangin dhunën. Në shkollat fillore, mësime të mesme bëjnë kontrollin e çantave, dhe rregullisht gjejnë thika, por kurrë jo armë zjarri. Mësime të mesme nuk ndjehen kompetentë që të kontrollojnë çantat, ndonëse, në disa intervista, kanë shfaqur dëshirën për ta bërë këtë.

Kërcënimet kryesisht shihen si diçka që vjen nga jashtë, rrugës për në shkollë dhe për në shtëpi, ose janë të lidhura me rrinë nga shkollat e tjera, etj. Në Kamenicë, për shembull, njësitë policore i shoqërojnë nxënësit deri tek autobusët shkollorë për t'u siguruar se asnjë bandë nuk po i kërcënon nxënësit rrugës për në autobus. Mësime të mesme ndjehen se prindërit nuk po bashkëpunojnë dhe janë të paimentuar për situatën e sigurisë në shkollë. Në fakt, ata në disa mënyra i kontribuojnë një klimë negative të sigurisë, meqë mësime të mesme ndonjëherë marrin edhe kërcënime gojore nga prindërit që janë të pakënaqur me arritjet e fëmijëve të tyre.

Këto intervista dëshmojnë se situata e sigurisë në shkollë është larg së qeni e përsosur. Kjo po ashtu tregon se kërcënimi kryesor nuk janë armët e vogla por rrahjet dhe kërcënimet pa armë, ose me armë siç janë zinxhirët, thikat, dhe shufrat metalike. Megjithatë, kjo nuk d.m.th. se armët mungojnë nga mjediset shkollorë. Dy incidentet tregojnë se armët janë të pranishme ndonjëherë. Meqë informatat mbi çështjet si këto shpesh nuk arrijnë deri te mësime të mesme, ka gjasë që armët të jenë më të pranishme sesa mendojnë mësime të mesme.¹⁰¹

VIII. Përfundimet

Përkundër luftës së paradokohshme dhe pasigurisë lidhur me statusin e saj të ardhshëm, situata në Kosovë përmban disa pikë të ndritura. Në më pak se katër vjet, Kosova ka dëshmuar zhvillim dhe përfundim të institucioneve publike dhe të atyre të rendit e të ligjit, si dhe formësimin e një sektori të sigurisë përherë më të përgjegjshëm. Ndonëse sfida strukturore, sociale dhe ekonomike ka ende, duke përfshirë papunësinë shumë të përhapur dhe tensionin e vazhduar ndëretnik, përparimi i Kosovës, në njëfarë mënyre, i ka tejkaluar pritjet e bashkësisë ndërkombëtare.

Pengesa kryesore për suksesin e këtyre përpjekjeve në të ardhmen, megjithatë, është gjendshmëria e vazhdueshme e gjerë e armëve dhe shpërdorimi i armëve të vogla dhe të lehta. Gjetjet e këtij SABA dëshmojnë se pushkët e sulmit dhe pistoletat vazhdojnë të trafikohen nga Serbia dhe Shqipëria, dhe posedohen nga një gamë e gjerë akterësh. Megjithë përpjekjet e vazhdueshme nga UNMIK-u dhe KFOR-i për t'i regjistruar dhe grumbulluar këto armë, rreth 330.000-460.000 sosh ende janë në duar të civilëve, akterëve të krimit të organizuar dhe të grupimeve politike.

Ky studim ka treguar se shpërdorimi i armëve të vogla ende paraqet kërcënim për sigurinë dhe mirëqenien e kosovarëve, si dhe për personelin vendor dhe ndërkombëtar të administratës së OKB-së dhe të agjencioneve të tjera. Ndonëse shkallët e lëndimeve vdekjeprurëse dhe jovdekjeprurëse duket se po ulen, kriminaliteti -- sidomos krimi i kryer me armë zjarri -- është duke u shtuar. Krahasuar me vendet e rajonit të Europës qendrore dhe lindore, armët e vogla shpërdoren në një numër shpërpjestimisht të lartë të vrasjeve dhe të plaçkitjeve.

Përpjekjet e UNDP-së, sidomos përmes programit të ardhshëm të AKZh-së, paraqsin një hap potencialisht të rëndësishëm, dhe duhet të mbikëqyren e të vlerësohen prej së afërmi. Por grumbullimi dhe shkatërrimi i armëve është vetëm hapi i parë. Megjithëse gjetjet e SABA-së sugjerojnë se kosovarët mund të kenë vullnet, nën disa rrethana, që t'i dorëzojnë armët e tyre, besimi i tyre në ofruesit vendorë dhe ndërkombëtarë të sigurisë ndryshon. AKZh-ja e propozuar prandaj duhet të përvetësojë objektiva modestë në hapat fillestarë.

Largimi i përhershëm dhe heqja e armëve të vogla nga Kosova mund të japë përfitime potencialisht të mëdha zhvillimore dhe simbolike. Është hap i nevojshëm, por jo i vetëmjaftueshëm, për sigurimin e stabilitetit dhe të sigurisë së Kosovës dhe të njerëzve të saj. Duke marrë parasaysh pasigurinë që ngulmon nëpër fqinjët e saj, kjo detyrë do të jetë e vështirë. Sidoqoftë, nëse bëhet me mbështetje adekuate politike dhe financiare dhe në bashkëpunim me programimin e tashëm zhvillimor, rezultatet mund të jenë premtuese për Kosovën dhe rajonin.

Fundnotat

- ¹ SABA përdori një varg instrumetesh hulumtuese duke përfshirë: (1) 1,200+ anketa familjare; (2) 12 grupe pjesë-marrëse të synuara në katër rajone përfaqësuese; (3) 15 intervista kyçe informative me ish-luftëtarë të UÇK-së nga të gjitha shtatë zonat operative; (4) intervista me 29 mësimdhënës dhe administratorë në 15 shkolla; dhe (5) intervista me personelin kyç në Institucionet e Vetëqeverisjes të Kosovës, UNMIK-un, OSBE-në dhe akterë të tjerë të sektorit të sigurisë. Ekipi i SABA -së po ashtu pati qasje ndaj bankës së të dhënave të Policisë së UNMIK-ut(SIPK), regjistrin të Spitalit Universitar të Prishtinës.
- ² Kjo pandehmë bazohet në elementet e mëposhtme: Rreth 60 deri në 70 për qind të 390.000 amvisërive në Kosovë posedojnë armë. Shkalla mesatare e armëmbajtjeve në këto amvisëri është rreth 1.4-1.7 armë.
- ³ Çështja se kush e ka persekutuar kë është e kon-testueshme: serbët e Kosovës ndonjëherë do të përpiqen ta arsyetojnë persekutimin e Millosheviq-it me atë se si janë trajtuar serbët etnikë në Kosovë në dekadat e fundit të pushtetit komunist.
- ⁴ Për një argument të ngjashëm, shih Heinemann-Grüder dhe Paes (2001, f. 20-21).
- ⁵ Është me rëndësi të kuptohet se ndërsa këto nuk janë urrejte 'të lashta' ose 'të amshueshme', konfliktet etnike nuk janë nxitur vetëm gjatë viteve ose dekadave të fundit. Ato në fakt datojnë që nga brofja e nacionalizmit si forcë mbizotëruese politike dhe sociale në Europë në shekullin XIX (shih Malcolm 1998, Hyrje).
- ⁶ Shifrat nga anketa për Living Standard Meusement Survey 2000, e cituar në SOK (2002). Shifra prej 6 për qind e minoritetit serb të Kosovës vjen nga UNMIK-u (2002). Shifrat për përbërjen etnike në Kosovë janë kontraveste, dhe për shumë dekada janë përdorë si mjet politik (për një diskutim të shkurtër, shih Malcolm 1998, xxxi-xxxii).
- ⁷ Për më shumë, situata ekonomike e komunitetit serb duket të jetë më e vështirë sesa në pjesën tjetër të Kosovës (Paes dhe Matveeva, 2003).
- ⁸ Për një raport përmbajtësor mbi situatën e të kthyerve, shih Velijevic (2003). Një tablo më e gjerë është dhënë në ICG (2002).
- ⁹ Përkrahja për liderët e moderuar politikë gradualisht është zbehur, megjithatë (Biele, 2002).
- ¹⁰ Në zgjedhjet e dyta komunale, bojkoti ishte i plotë në qytetin e ndarë të Mitrovicës.
- ¹¹ Kjo shkon ndesh me trendin e përgjithshëm, të uljes graduale në pjesëmarrjen në votime gjatë tri zgjedhjeve, prej 79 për qind në vitin 2000 në 53.9 për qind më 2002.
- ¹² ICG (2001, f. 17). E vetmja parti e serbëve të Kosovës që merr pjesë në zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës, partia 'Kthimi' sot i zë këto dhjetë vende.
- ¹³ Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) ende ka 'pushtet të rezervuar' mbi këto fusha: shpërndarjen e Kuvendit dhe thirrjen për zgjedhje të reja, autoritetin përfundimtar për të miratuar buxhetin e Kosovës; autoritetin përfundimtar mbi sistemin juridik (caktimi dhe largimi i gjykatësve dhe prokurorëve), vënien e ligjit dhe të institucioneve përmirësuese, kontrollin mbi Trupat Mbrojtëse të Kosovës, marrëdhëniet e jashtme, kontroll mbi transitin ndërkuftar të mallrave, mbrojtjen e minoriteteve, administrimin e pronave shtetërore dhe të pronave të tjera publike etj. (UNDP, 2002a, Kutia 2.4).
- ¹⁴ Ndonëse statusi i Malit të Zi ndryshonte nga ai i Kosovës brenda Federatës Jugosllave (Mali i Zi ishte republikë konstitutive e Federatës ndërsa Kosova ishte pjesë e Serbisë), Kosova kishte autonomi substanciale, dhe në shumë mënyra ngjasonte me Kroacinë, Slloveninë, Malin e Zi, Bosnjën e Hercegovinën në kuptimin e pushteteve dhe të të drejtave.
- ¹⁵ Është kështu edhe pse Kosova gjithmonë ka qenë më e pazhvilluara pjesë e ish-Jugosllavisë. Për një vështrim të situatës në Shqipëri shih UNDP (2002c).
- ¹⁶ Operacioni i NATO-s 'Essencial Harvest' e Gusht-Statorit 2001 mblodhi gjithsej 3.875 armë dhe 397.625 mina, eksplozivë dhe municion (Small Arms Survey, 2002, tabela 7.9). Megjithatë, cilësia e armëve në mesatare nuk ishte shumë e lartë dhe duket se shumë armë të përdorshme për luftë mund të jenë mbajtur nga grupet guerile.
- ¹⁷ Intervistat, personeli i sektorit të sigurisë që punon në Kosovë, 27 Shkurt 2003.
- ¹⁸ Anketat e opinionit më 2001 dhe 2002 thonë se afro 100 për qind të shqiptarëve të Kosovës do të votonin në favor të pavarësisë, dhe një përqindje e njëjtë e serbëve të Kosovës do të votonin kundër (UNDP, 2002a, Kutia 2.5).
- ¹⁹ Papunësia e matur me metodën ILO, theksuar në UNMIK (2002).
- ²⁰ UNMIK Komunikatë shtypi e Policisë, 29 Tetor 2002; shih UNDP (2003, f. 25).
- ²¹ Anketa e opinionit e kryer për këtë raport tregon se rreth 90 për qind të respondentëve do të shkonin në polici nëse do të plaçkiteshin ose të kërcënoheshin seriozisht (shih Shtojcën 1). Megjithatë, anketat e tjera të opinionit të UNDP-së kanë arritur në numra më të ulët; shih UNDP (2002b, f. 24; 2003, f. 28).

- ²² Kalkuluar nga SIPK. Ulja në nivelet e vrasjeve ndëretnike duhet interpretuar me kujdes. Kjo është më pak pasojë e raporteve të përmirësuar ndëretnike sesa vjen nga fakti se komunitetet janë më të ndara sot sesa në periudhën fill mbas luftës.
- ²³ Nga mesi i kategorisë 'të tjerët', 71 për qind ndjeheshin 'të sigurt' ose 'shumë të sigurt'.
- ²⁴ Komunitetet e tjera minoritare, si boshnjakët, romët, turqit po ashtu janë përfshirë në anketë. Megjithatë, numri i tyre nuk është mjaft i madh për të dhënë rezultate me rëndësi statistike. Prandaj këto grupe nuk diskutohen më tej në këtë raport.
- ²⁵ Meqë patentat e shoferëve nuk ishin lëshuar për tre vjet gjatë konfliktit, ka mjaft ngasës të patrajnuar dhe vozitës të dobët nëpër rrugët e Kosovës.
- ²⁶ Me 'centralizim' këta njerëz me siguri mendojnë centralizim i pushtetit politik në Prishtinë (për dallim nga strukturat qeveritare të forta komunale).
- ²⁷ Prandaj preferojnë përbërësin lokal të forcës policore kundrejt policisë ndërkombëtare, edhe pse të dyja janë pjesë e të njëjtës organizatë-Policisë së UNMIK-ut.
- ²⁸ Ministarstvo Unutrasnjih Poslova (Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë).
- ²⁹ Numrat e trupave të KFOR-it janë ulur me rreth 30 për qind nga fuqia origjinale prej 42.000 meshkujsh e femraash.
- ³⁰ Intervistë, personeli që punon në sektorin e sigurisë në Kosovë, 22 Janar 2003.
- ³¹ Për një diskutim të hises së ndalimeve të bëra prej policisë në numrin e gjithsejtë të ndalimeve të AVL-ve, shih Small Arms Survey (2001, kapitulli 2).
- ³² Sidoqoftë, ka pandehma se policia jugosllave, sikurse edhe elemente të AJ-së (Armatës Jugosllave), vazhdojnë të jenë veprimtarë aktivë në nëntokë në disa enklava, sidomos në Mitrovicën veriore. Sipas një burimi të konsultuar nga SAS, 40 oficerë të shërbimeve sekrete serbe operojnë në Mitrovicën veriore.
- ³³ Përditësimi ditor i shtypit nga Polica e UNMIK-ut, 27 janar 2003 <<http://www.Kosovapolice.org/english/dreports/DPU280103.htm>>.
- ³⁴ Intervistë, personeli që punon në sektorin e sigurisë në Kosovë, 22 janar 2003, 2 mars 2003.
- ³⁵ Për shpjegimin e konceptit të shumëzuesit, shih Kutinë 4.1.
- ³⁶ Intervistë, personeli që punon në sektorin e sigurisë në Kosovë, 22 Janar 2003.
- ³⁷ Kjo marrëveshje është pjesë e Deklaratës së Parimeve të nënshkruar nga komandantët e KFOR-it dhe TMK-ja më 20 Shtator 1999. Intervista, personeli që punon në sektorin e sigurisë në Kosovë, 22 Janar 2003.
- ³⁸ Intervistë, personeli që punon në sektorin e sigurisë në Kosovë, 28 Shkurt 2003.
- ³⁹ Ky numër është konfirmuar edhe nga baza e të dhënave e IOM-it për ish-luftëtarët e UÇK-së. Sipas tij, vetëm dy për qind të luftëtarëve ishin aktivë në UÇK para vitit 1998. Shumica u bashkëngjitën në vitin 1998 (36 për qind në gjysmën e parë, 21 për qind në të dytën). Pjesa tjetër, më shumë se 40 për qind, u futën në rradhët e UÇK-së në vitin 1999 (cituar në Heinemann-Grüder dhe Paes, 2001, f. 25).
- ⁴⁰ Intervistë me ish-luftëtarë të UÇK-së, e bërë nga Kosova Initiative for Democratic Society (KIDS) për SABA, shkurt 2003.
- ⁴¹ Intervistë me ish-luftëtarë të UÇK-së, e bërë nga KIDS për SABA, shkurt 2003.
- ⁴² 'Ndërmarrja e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së', e nënshkruar me 20 qershor 1999, paragrafet 22-26. Pushkët jo-automatike me tyta të gjata lejoheshin me leje speciale nga KFOR-i.
- ⁴³ Për shembull, në katundin Vlladovë, marincat amerikanë çarmatosën rreth 200 luftëtarë të UÇK-së (Heinmann-Grueder dhe Paes, 2001, f. 19).
- ⁴⁴ Sfondi i kësaj është se Armata Jugosllave për kohë të gjatë kishte sukses në atë që UÇK-në dhe me këtë edhe vetë armatimin e UÇK-së, ta mbante larg, afër kufirit të Kosovës me Shqipërinë. Tërheqja e përnjëhershme e AJ-së në qershor 1999 bëri që luftëtarët e UÇK-së shpejt (dhe me pak armë) të hyjnë në Kosovë, duke lënë shumë armë mbrapa (Ripley, 2000, f. 23).
- ⁴⁵ Intervistë me personelin që punon në sektorin e sigurisë në Kosovë, 27 Shkurt 2003.
- ⁴⁶ Të dhëna të ofruara nga KFOR-i, Mars 2003.
- ⁴⁷ Të dhëna të ofruara nga KFOR-i, Mars 2003.
- ⁴⁸ Të dhëna të ofruara nga KFOR-i, Mars 2003.
- ⁴⁹ Të dhëna të ofruara nga KFOR-i, Mars 2003.
- ⁵⁰ Për hollësi të armatosjes gjatë taktikës 'lufta popullore' shih Small Arms Survey (2002, Kap. 2).
